



MIRËSEARDHËT NË SCHAFFHAUSEN

Një udhëzues për të ardhur të rinj



2

IMPRESSUM:

- Herausgeber: Kanton Schaffhausen, Departement des Innern
2. Auflage: 2024
Redaktion: Integres, Integrationsfachstelle für die Region Schaffhausen,
Anlaufstelle für Diskriminierungsschutz und interkulturelle Konflikte
Flavia Brühlmann und Chantal Bründler
- Bezugsquellen: Sekretariat Departement des Innern
Mühlentalstr. 105
8200 Schaffhausen
Tel. +41 52 632 74 61 / Email sekretariat.di@ktsh.ch
- Integres
Tel.+41 52 624 88 67 / Email info@integres.ch
- Gestaltung: Sepp Pircher
Bildquellen: Chantal Bründler: *Seite 12, 16, 21, 23 L/R, 24*
Gino Gallucci: *Seite 39*
profifoto.ch - Michael Kessler: *Seite 31, 37*
SAH Schaffhausen: *Seite 20, 36 L*
Sepp Pircher: *Seite 6 M/R, 8 L, 15 R, 18, 20 L, 28, 30, 32, 33 R, 36 R, 38*
Stadtarchiv Schaffhausen: *Seite 3, 9, 11, 19, 23 M, 25, 26, 27, 34, 36 M*
VBSH: *Seite 10, 17*
www.parlament.ch: *Seite 6 L*
Wirtschaftsförderung Kanton Schaffhausen, Fotograf Röbi Bösch: *Seite 1, 2, 4, 5, 7, 8 M, 9 R, 13, 14, 15 L, 22, 28, 29, 33, 35, 40*
(L = Links, M = Mitte, R = Rechts auf der Seite)
- Druck: Druckwerk SH AG, Schweizernbildstrasse 30, Postfach, 8207 Schaffhausen
Gedruckt auf: Refutura blauer Engel + Recycling,matt,ISO-Weisse 100, 100% 100 g/m2

PASQYRA E LËNDËS



MIRËSEARDHËT!	4
GRÛEZI MITENAND!	5
ZVICRA E SHUMËLLOJSHME	6
REGJIONI SCHAFFHAUSEN	7
VLERAT THEMELORE	9
MBËRRITJA & QËNDRIMI	10
NDËRKUPTIMI DHE INTEGRIMI	11
BANIMI	13
MOBILITETI	16
PUNA	18
SIGURIA SOCIALE	20
TAKSAT	22
MARTESA DHE PARTNERITETI	23
FAMILJA DHE FËMIJËT	25
SHKOLLA	28
FORMIMI PROFESIONAL DHE STUDIMI	30
SHËNDETI	32
KOHA E LIRË DHE KULTURA	34
PREOKUPIMET E PËRDITSHME	36
JETA POLITIKE	37
INTEGRES	39

MIRËSEARDHËT!



4

Mirëseardhje e përzemërt në kantonin Schaffhausen!

Ne gëzohemi shumë, që ju keni ardhur të banoni në kantonin tonë të hapur dhe njëkohësisht të lidhur me traditën.

Kantoni i Schaffhausen-it ju ofron kushte atraktive të jetës dhe të punës me lidhje të mira qarkullimi dhe marrëdhënie të mira me kantonet fqinj Thurgau dhe Cyrih si dhe me Gjermaninë e afërt kufitare. Ne jemi së sigurt që ju dhe familja juaj shpejt do të ndiheni mirë jo së fundi edhe falë peizazhit të pacenuar natyror, zonës së afërt për çlodhje pranë Rin-it dhe në Randen si dhe rajonit të prodhimit të verës Klettgau.

Globalizimi, ndryshimi shoqëror dhe ndryshimet e mjedisit na vendosin ne si shoqëri para një sfide të madhe. Respekti i ndërsjellë, toleranca dhe çiltërsia ndaj bashkëqytetarëve janë vlera bazë të rëndësishme dhe kontribuojnë edhe në kulturën e mirëseardhjes së kantonit të Schaffhausen-it.

Merrni pjesë në jetën shoqërore me evenimentet e saj kulturore dhe ofertat e saj të arsimimit. Një shkëmbim aktiv dhe i shpeshtë ndërmjet popullsisë vendase dhe të sapoardhur kontribuon në mënyrë vendimtare në atë, që në kantonin e Schaffhausen-it të ndiheni si në shtëpi. Kjo broshurë ju ndihmon që të mblidhni shumë informacione të dobishme mbi vendbanimin tuaj të ri dhe ju mbështet që të arrini mirë në vendin tuaj të ri të jetesës.

Unë ju uroj shumë kënaqësi gjatë eksplorimit të kantonit të Schaffhausen-it dhe në emër të Këshillit të Qeverisë ju uroj mirëseardhjen e përzemërt.

Walter Vogelsanger, Këshilltar i Qeverisë

WILLKOMMEN!



Herzlich willkommen im Kanton Schaffhausen!

5

Es freut uns sehr, dass Sie in unseren aufgeschlossenen und gleichzeitig traditionsverbundenen Kanton zugezogen sind.

Der Kanton Schaffhausen bietet Ihnen attraktive Lebens- und Arbeitsbedingungen mit hervorragenden Verkehrsverbindungen und guten Beziehungen zu den Nachbarkantonen Thurgau und Zürich sowie dem grenznahen Deutschland.

Wir sind sicher, dass Sie und Ihre Familie sich nicht zuletzt auch dank der intakten Naturlandschaft, dem Naherholungsgebiet am Rhein und auf dem Randen sowie dem Weinbaugebiet Klettgau schnell wohl fühlen werden.

Die Globalisierung, der gesellschaftliche Wandel und die Umweltveränderungen stellen uns als Gesellschaft vor grosse Herausforderungen. Gegenseitiger Respekt, Toleranz und Offenheit gegenüber den Mitmenschen sind wichtige Grundwerte und tragen auch zur Willkommenskultur des Kantons Schaffhausen bei.

Nehmen Sie am gesellschaftlichen Leben mit seinen kulturellen Veranstaltungen und Bildungsangeboten teil. Ein aktiver und reger Austausch zwischen der einheimischen und zugezogenen Bevölkerung trägt massgeblich dazu bei, sich im Kanton Schaffhausen heimisch zu fühlen. Diese Broschüre hilft Ihnen viele nützliche Informationen über Ihren neuen Wohnkanton zu sammeln und unterstützt Sie gut an Ihrem neuen Lebensort anzukommen.

Ich wünsche Ihnen beim Erkunden des Kantons Schaffhausen viel Freude und heisse Sie im Namen des Regierungsrates herzlich willkommen.

Walter Vogelsanger, Regierungsrat

ZVICRA E SHUMËLLOJSHME



6

SRUKTURA E ZVICRËS

Zvicra është një vend i vogël, i cili përbëhet nga katër regjione të ndryshme gjuhësore. Në këto zona fliten katër gjuhët zyrtare të vendit: Gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht.

Por në regjionet e ndryshme ju do të gjeni pak a shumë mënyra të ndryshme jetese. Zvicra është një komb me vullnet: Ajo nuk formon as etnikisht, as gjuhësisht, as nga feja një njësi.

Ndërtimi i shtetit në Zvicër është federalist dhe ndahet në tre nivele politike: Federata, kantonet dhe komunat. Kushtetuta e federatës formon rregullin themelor dhe cakton parimet më kryesore të bashkëjetesës. Ajo përcakton ndarjen e detyrave ndërmjet federatës dhe kantoneve dhe kompetencat e autoriteteve.

FEDERATA

Federata është emërtimi zvicëran për shtetin kombëtar. Fjala tjetër e përdorur më shpesh për këtë është konfederata. Federata është kudo kompetente, atje ku kushtetuta e federatës e autorizon për këtë. Kështu për shembull në vendosjen e normave të vlefshme ligjore në mbarë vendin, në politikën e jashtme dhe atë të sigurimit ose në rast të doganës ose në çështjet financiare. Detyrat, të cilat nuk janë shprehimisht çështje të federatës, bien në kompetencën e nivelit tjetër të mëposhtëm: të atij të kantoneve.

KANTONET

Zvicra përbëhet gjithsej nga 26 kantone. Kantonet, shpesh të quajtura edhe vende, janë shtetet fillestare, të cilat u bashkuan në vitin 1848 në federatë. Çdo kanton ka një kushtetutë vetjake, një parlament vetjak, një qeveri dhe gjykata.

KOMUNAT

Si të gjitha kantonet, kantoni Schaffhausen është i ndarë në komuna. Rreth një e pesta e komunave ka një parlament vetjak. Këtu populli mund të vendosë direkt vetëm në rast të pyetjeve të rëndësishme mbi referendumin shtesë ose të detyrueshëm. Katër të pestat e komunave të Schaffhausen-it janë organizuar si demokraci direkte. Vendimet merren këtu në kuvendin e komunës. Komunat mbajnë me porosi të federatës dhe të kantoneve regjistrin e banorëve. Ato vendosin përveç kësaj mbi çështjet e shkollës dhe ato sociale, furnizimin me energji, ndërtimet e rrugëve dhe planifikimin e vendit ose për taksat komunale. Vëllimin e autonomisë së komunave e vendosin kantonet e veçanta. Prandaj kjo e drejtë është e ndryshme. Prandaj kjo rezultojnë të jetë goxha ndryshe.

- ▶ Sekretariati i Shtetit për Migrim (Staatssekretariat für Migration SEM): «Mirë se vini në Zvicër» – broshurë informimi e SEM për të ardhur të rinj. E përkthyer në shumë gjuhë.
- ▶ ch.ch: Shpjegon Zvicrën dhe autoritetet e saj. Në të gjitha gjuhët e vendit si dhe anglisht.
- ▶ Departamenti Zvicëran i Punëve të Jashtme (Eidgenössisches Departement für auswärtige Angelegenheiten EDA) – About Switzerland: Portali zyrtar i informacionit të federatës për Zvicrën. E përkthyer në shumë gjuhë migrimi
- ▶ SWI swissinfo.ch: SWI swissinfo.ch ofron lajme të pavarura nga Zvicra, të përkthyer në 10 gjuhë.

REGJIONI SCHAFFHAUSEN



REGJION I PAVARUR

Kush jeton në Schaffhausen, vlerëson marrëdhëniet e kapshme me një vështrim, kualitetin e lartë të jetës, pozicionin e bukur të banimit, zonat e afërta për çlodhje përpara derës dhe ofertën mbi mesatare në kulturë dhe sport. Si kantoni më verior i Zvicrës, Schaffhausen-i është i rrethuar në pjesën më të madhe nga Gjermania. 82 % e kufirit prej 185 km të gjatë takohet me landin federal gjerman të Baden-Württemberg-ut. Kantonin e rrethojnë 1740 gurë kufiri. Autoritetet përkujdesen prandaj në nivelet më të ndryshme për një kontakt të hapur dhe konstruktiv, jo vetëm me kantonet fqinjë, por edhe me fqinjët gjermanë.

Kantoni ndahet në tre zona të ndara nga njëra-tjetra, të cilat shtrihen të gjitha në veri të Renit. Pjesa kryesore shtrihet nga kthesa e Renit në Schaffhausen dhe Neuhausen në ujëvarën e Renit në Klettgau, në zonën e [mali] Rand dhe të rrafshnaltës së Reiat. Në lindje shtrihet Steiner Zipfel në derdhje të liqenit „Untersee“ dhe në ju-

gperëndim pjesa e poshtme e kantonit me të dy fshatra Buchberg dhe Rüdlingen.


Krahina rreth Schaffhausen-it shtrihet në anën e pjesës qendrore zvicerane. Kodrat e buta dhe luginat bëjnë pjesë tek malet më të ulëta të Juras dhe dëshmojnë për lëvizjet e akullnajave gjatë periudhës së fundit të akullnajave.

Panorama e topografisë është e shumëformëshe dhe në mënyrë të veçantë e karakterizuar nga Reni me një topografi të pazakontë lumi, nga zonat e mëdha të pyjeve, tokën e madhe bujqësore dhe malet e vreshtave të shërbyera me kujdes.

Sipërfaqja e kantonit është 298 kilometra katrore dhe i përgjigjet 0,7 % të territorit të përgjithshëm të Zvicrës. Mbi 84'000 njerëz jetojnë në 26 komunat e kantonit, këta janë rreth 1 % e popullsisë së përgjithshme zvicerane. Schaffhausen-i i përket kantoneve më të vegjël në Zvicër.

7

► *Kantoni Schaffhausen – Portali komunal:
Të gjitha komunat e Schaffhausen-it në një vështrim.*



REGJIONI SCHAFFHAUSEN



8

HISTORIA

Me popullimin nëpërmjet të alemanëve vendoset në mesjetën e hershme struktura e sotme e ngujimeve e regjionit të Schaffhausen-it. Nga shekulli i 7-të janë të njohura mbetje alemaniane pothuajse nga e gjithë zona e kantonit. Ngujimet më të rëndësishme gjenden megjithatë tanimë në kohën e romakëve, në Schleithelm dhe Stein am Rhein.

Pas vitit 1000 jeta ekonomike e regjionit, e karakterizuar deri tani para së gjithash nga bujqësia, pësoi një dinamikë të madhe. Më së voni në shekullin e 11-të lidhja me Renin do të bëhet më e rëndësishme. Dhënia borxh e të drejtave të monedhave dhe të tregut në Schaffhausen dhe Stein am Rhein dhe veçanërisht rritja e shpejtë e qytetit të Schaffhausen-it shpjegohen me rritjen e aktiviteteve tregtar. Ndërprerjen e rrugës së rëndësishme ujore nëpërmjet ujëvarës së Renit banorët e Schaffhausen-it e shfrytëzonin për punime ringarkimi dhe transporti kundrejt taksash dhe tatimesh doganore përkatëse. Me përfitim të të drejtave të pushtetit mbi fshatrat e rrethina fillon ndërtimi i një qytet-shteti të fortë.

Në mesjetë Schaffhausen-i bie shpesh ndërmjet fronteve të fuqive të mëdha. Për të ruajtur pavarësinë Schaffhausen-i hyn në vitin 1501 në lidhjen e konfederatës dhe merr përsipër të sigurojë kufijtë veriorë të konfederatës, ku bën pjesë po ashtu edhe kalaja e Munot-it e ngritur gjerësisht me punë të detyruar, sot shenjë karakteristike e qytetit.

ZGJIMI DEMOKRATIK

Në fund të shekullit të 18-të përfaqësuesit e korporatave qytetare qeverisnin pa kufizim mbi të nënshtruarit e krahinave. Me kthesën rrënjësore të revolucionit francez banorët e krahinave përfituan me luftë të njëjtat të drejta dhe liri si banorët e qytetit. Në shekullin e 19-të krijohet kantoni, qyteti i Schaffhausen-it si dhe 35 komuna të pavarura.

Deri në fillim të shekullit të 19-të banorët e Schaffhausen-it jetonin nga bujqësia, zeytaria dhe tregtia. Kjo ndryshon me angazhimin e pionierëve të industrisë, të cilët vendosën gurin e themelit për një rindërtim të thellë të ekonomisë. Schaffhausen-i zhvillohet në shekullin e 19-të dhe të 20-të në një vendndodhje të rëndësishme industriale me firma të shumta të dëgjura.

ZHVILLIMI EKONOMIK

Në vitet 1950 dhe 1960 regjioni përfiton nga rritja e përgjithshme ekonomike. Ndërmarrjet e ngulura prej kohësh si Georg Fischer, SIG, IVF dhe të tjera bumojnë, këtu shtohen edhe ndërmarrje të reja. Të papunë pothuajse nuk ka fare. Në të kundërtën: Forcat e punës janë të rralla dhe duhet të sillen në vend nga jashtë - në atë kohë para së gjithash nga Italia.

Kriza e viteve 1990 çon në një pakësim radikal të vendeve të punës në industri. Schaffhausen-i duhet të riorientohet dhe ta përshtatë ekonominë e tij më gjerë. Me fillimin e ngulimit të firmave të reja dhe me rindërtimin e ndërmarrjeve ekzistuese shtohet domethënia e sektorit të shërbimeve. Për ndërmarrje vepruese internacionale regjioni i Schaffhausen-it është një vendndodhje ekonomike atraktive dhe inovative, e cila në konkursin global tregohet e aftë konkurruese. Pas një rënie të ndjeshme në vitet 1990, popullsia që prej disa vitesh shtohet përsëri. Sërish vjen një numër i madh emigrantësh nga jashtë shtetit, shumë nga vendi fqinj Gjermania, por edhe nga e gjithë bota.

► *Muzeu i gjithë shenjtoreve ((Museum zu Allerheiligen) bashkon historinë, arkeologjinë, artin dhe diturinë e natyrës nën një strehë, në veçanti po ashtu nga regjioni i Schaffhausen-it. Në çdo të shtunë të parë në muaj hyrja është falas.*

► *Nxijtja e ekonomisë e Schaffhausen-it (Wirtschaftsförderung Schaffhausen): Informacione për regjionin ekonomik të Schaffhausen-it*

VLERAT THEMELORE



TË DREJTAT THEMELORE

Zvicra dhe me këtë edhe kantoni Schaffhausen i venë rëndësi lirisë, të drejtave dhe detyrimeve të çdo individit. Bazën për një bashkëjetesë të mirë e formojnë respekti dhe toleranca kundrejt njëri-tjetrit si dhe njohja e vlerave të njëjta themelore.

Vlerat themelore janë të përcaktuara në kushtetutën e federatës dhe në kushtetutën e kantonit. Këto të drejta i kanë të gjithë banoret dhe banorët e Zvicrës, pra edhe të huajat dhe të huajt:

Barazia ligjore

Shteti duhet t'i trajtojë të gjithë njerëzit njëllë. Kjo do të thotë që askush nuk lejohet të pengohet, s'ka rëndësi cilën gjini ose moshë ka dikush, cilën prejardhje, racë, gjuhë, fe, pozitë sociale, botëkuptim, mënyrë jetese ose cenim.

Barazia e të drejtave

Burra dhe gra kanë të njëjtat të drejta në familje, në formimin profesional dhe në punë. Burra dhe gra kanë pretendim për të njëjtën rrogë për punë me vlerë të njëjtë.

E drejta për jetën dhe lirinë personale

Çdo njeri ka të drejtën për jetën. Dënimi me vdekje është i ndaluar. Të gjithë kanë të drejtën për lirinë personale. Kjo do të thotë që asnjëri nuk lejohet të lëndohet dhe që të gjithë lejohet të lëvizin lirshëm.

E drejta për martesë

Çdo person mbi 18 vjet lejohet të martohet.

E drejta e besimit

Çdo person lejohet ta zgjedhë dhe ta praktikojë lirisht fenë e tij. Askush nuk lejohet të detyrohet, të aderojë ose t'i përkasë një bashkësie fetare.

Komunitete fetare të njohura nga ana e së drejtës publike:

Në kantonin e Schaffhausen-it ekzistojnë tre bashkësi fetare, të cilat janë të njohura nga ana e së drejtës publike.

Ato janë kisha e landit e reformuar evangjelike, katolike romake dhe katolike krishtere. Nga kjo njohje e së drejtës publike rezultojnë nga njëra anë të drejta të caktuara si tatimi i kishës, nga ana tjetër njohja është e lidhur me njohjen e lirisë së fesë, respektin për të drejtat e njeriut dhe të transparencës financiare.

Liria e mendimit

Çdo person lejohet ta formojë lirisht mendimin e tij dhe ta shprehë lirisht atë në kuadrin e ligjit. Këto të drejta mund të kufizohen në rrethana të caktuara nga shteti. Për këtë nevojitet një bazë ligjore. Shiheni ju të kërcënuar në të drejtat tuaja personale, ka sipas shtrimit të pyetjes, ndihmë këshilluese ose ligjore.

- ▶ Në Schaffhausen ka vende për këshillime ligjore falas ose me kosto të leverdishme për të gjitha çështjet ligjore.
-Vend këshillimi për të drejtën e azilit dhe të huajve, SAH Schaffhausen
-Sekretariati kantonal i punës në Schaffhausen
- ▶ Integres Schaffhausen – pikë kontakti për mbrojtjen ndaj diskriminimit dhe konflikte ndërkulturore: Vend këshillimi për njerëz, të cilët për shkak të prejardhjes, ngjyrës së lëkurës, fesë së tyre ose veçorive të tjera ndihen të diskriminuar. Këshillimi është falas.

Detyrimet: Detyrimi për shërbim ushtarak dhe detyrimi për votim

Krahas të drejtave themelore ka për qytetarët dhe qytetarët zviceranë edhe detyrime. Kështu njih Zvicra, me ushtrinë e saj prej milicësh, detyrimin për shërbimin e përgjithshëm ushtarak. Në këtë janë të përfshirë të gjithë burrat zviceranë.

Një tjetër detyrim të veçantë njih kantonin e Schaffhausen-it. Këtu janë të gjithë qytetarët dhe qytetarët të detyruar për dhënien e votës gjatë zgjedhjeve dhe votimeve.

MBËRRITJA DHE QËNDRIMI



10

RREGULLAT E QËNDRIMIT

Qëndrimi në Zvicër rregullohet nëpërmjet miratimeve të ndryshme. Më të rëndësishmet janë leje qëndrimi i shkurtër (më pak se një vit), leje qëndrimi (i kufizuar) dhe leje qëndrimi i përhershëm (i pakufizuar). Kushtet e dhënies janë në varësi të qëllimit të qëndrimit dhe të shtetësisë. Në mënyrë të veçantë dallohet sipas kësaj, nëse personi vjen nga një vend i BE/EFTA apo nga një vend i tretë. Regjistrimi bëhet tek kontrolli i banorëve të komunës suaj të banimit. Edhe nëse ju keni banuar tanimë në një komunë tjetër të Schaffhausen-it, regjistrimi personalisht tek kontrolli i banorëve.

Letërnjoftimet më të rëndësishme të të huajve janë:

- Letërnjoftim B: Qëndruar/e
- Letërnjoftim C: Qëndruar/e i/e përhershëm/me
- Letërnjoftim L: Qëndruar/e shkurt
- Letërnjoftim G: Kalues/e kufiri
- Letërnjoftim N: Azilkërkuesë
- Letërnjoftim F: I/e huaj i/e pranuar paraprakisht
- Letërnjoftim S: Me nevojë për mbrojtje

ZYRA E MIGRIMIT DHE ZYRA E PASAPORTAVE

Zyra e Migrimit dhe Zyra e Pasaportave të kantonit të Schaffhausen-it është kompetente për detyra administrative në fushën e legjislacionit të të huajve të federatës. Informacione p.sh. lidhur me hyrjen, lejen e qëndrimit dhe bashkimin familjar mund të merren atje.

BASHKIMI FAMILJAR

Nënshtetas të EU [Bashkimit Evropian]/EFTA [Asociacionit Evropian të Tregut të Lirë] si rregull, pavarësisht nga lloji i lejes së tyre të qëndrimit, mund të tërheqin pjesëtarët e familjes së tyre. Si pjesëtarë të familjes vlejné bashkëshortët, prindërit dhe fëmijët, të cilët nuk janë ende 21 vjeç ose mjetet e jetesës së të cilëve sigurohen. Persona jashtë shteteve të EU/EFTA-së, nën marrjen parasysh të kushteve paraprake ligjore, mund të dorëzojnë tek kontrolli i banorëve të komunës së tyre të banimit një kërkesë për bashkim familjar (bashkëshortë dhe fëmijë të pamartuar nën 18 vjet). Duhet të merret parasysh se bashkimi familjar duhet të kryhet brenda afateve të përcaktuara. Informacione të detajuara dhe formularë përkatës për kërkesa ju i merrni në zyrën kantonale të migracionit.

- Sekretariati i Shtetit për Migrim (Staatssekretariat für Migration SEM): Informacione të hollësishme për hyrjen në Zvicër dhe për qëndrim, azil dhe punë në Zvicër.
- Kontrolli i banorëve: Të dhënat e kontaktit dhe oraret e hapjes në faqet e internetit të komunave në kantonin e Schaffhausen-it.
- Kantoni i Schaffhausen-it – Zyra e Punës (Arbeitsamt): Informacione për leje pune, ndërmjetësim pune dhe procedurë regjistrimi për punëmarrës dhe punëdhënës.

INFORMATION FILLESTAR

Personat e sapoardhur në kanton do të informohen dhe këshillohen lidhur me kushtet e jetesës dhe të punës në Zvicër dhe në kantonin e Schaffhausen-it. Me dorëzimin e materialeve të informimit Kontrolli i banorëve, gjatë regjistrimit në komunën e banorëve, ndërmjetëson njohuri të para orientuese. Si shtesë ekziston oferta e një bisede këshilluese falas tek vendi i specializuar për integrim „Integres“.

NDËRKUPTIMI DHE INTEGRIMI



POLITIKA E INTEGRIMIT DHE KËSHILLIMI

Këshilli i qeverisë së kantonit të Schaffhausen-it dhe këshilli i qytetit të Schaffhausen-it kanë miratuar në vitin 2003 linja drejtuese për një politikë koherente integrimi në kanton. Linjat drejtuese parashtrajnë, si mund të përmirësohet hyrja në jetën e përditshme profesionale, sociale, kulturore, gjuhësore dhe politike për popullsinë migrante. Me këtë angazhohet kantoni dhe qyteti i Schaffhausen-it aktivisht për fuqizimin e integrimit dhe të bashkëjetesës në regjionin e Schaffhausen-it.

„Integres“ është vendi i specializuar për integrimin i regjionit të Schaffhausen-it. Këtu këshillohen persona të veçantë por edhe biznese, autoritete dhe institucione, nëse ata kanë dëshira ose pyetje për integrimin dhe migracionin.

- ▶ *Integres, vendi i specializuar për integrimin e regjionit të Schaffhausen-it: Këshillime falas në rast të pyetjeve për integrimin dhe migracionin.*
- ▶ *Linjat drejtuese për një politikë koherente integrimi (Leitlinien für eine kohärente Integrationspolitik) ju i gjeni në faqen e internetit të „Integres“.*

KRITERET E INTEGRIMIT

Ligji për të huaj dhe integrim (AIG) përcakton kritere të integrimit dhe synon për këtë që të promovojë integrimin e të huajave dhe të huajve nëpërmjet shmangies së pengesave të integrimit. Njëkohësisht ai kërkon në mënyrë të detyrueshme përgjegjësinë vetjake për integrimin. Vlen parimi: Sa më shumë të drejta të marrin personat me shtetësi të huaj, aq më mirë duhet të jetë integrimi. Kjo do të thotë se veçanërisht njohuritë e gjuhës janë të lidhura ngushtë me statutin e qëndrimit. Kriteret e mëposhtme të integrimit janë të përfshira në AIG:

- Përvetësimi i njohurive gjuhësore
- Marrja parasyshe e sigurisë dhe rendit publik
- Respektimi i kushtetutës federale dhe vlerave të saj

- Pjesëmarrja në jetën ekonomike ose në fitimin e arsimit

Nëse kriteret e integrimit nuk plotësohen, atëherë leja e qëndrimit nuk mund të zgjatet respektivisht të prapësohet. Edhe leja e përhershme e qëndrimit mund të prapësohet ose të zvogëlohet në një tjetër leje qëndrimi. Po ashtu mund të refuzohet bashkimi familjar ose të refuzohen kërkesat e marrjes së shtetësisë.

GJERMANISHTJA SI GJUHË E PËRBASHKËT

Zvicra është një vend shumëgjuhësh. Një komunikim funksionues i mirë është çelësi për integrimin. Të komunikosh do të thotë, të kuptosh dhe të kuptohesh. Një gjuhë e përbashkët formon bazamentin për këtë. Në kantonin e Schaffhausen-it flitet gjermanisht. Gjuha zyrtare është gjermanishtja letrare. Në jetën e përditshme shpesh përdoret dialekti zvicero-gjerman. Të kuptohet dhe të flitet gjermanisht është një kusht paraprak për të kuptuarit në jetën e përditshme dhe në botën e punës. Gjuha e përbashkët formon një bazë të rëndësishme për bashkëjetesën.

TË MËSUARIT E GJERMANISHTES

Në regjionin e Schaffhausen-it ka shumë kurse gjermanishteje.

Paleta e ofertës është e gjerë. Krahas kurseve të zakonshme të gjermanishtes ka edhe të tilla për nëna me përkujdesje për fëmijët, për të rinj dhe të rinjtë e rritur me perspektivë të formimit shkollor ose edhe oferta për fëmijë dhe grupe të tjera. „Integres“ ju këshillon juve gjatë zgjedhjes së një oferte të përshtatshme.

- ▶ *Integres – Pasqyrë e kurseve të gjermanishtes dhe oferta të integrimit: Informacione dhe këshillim për oferta të gjermanishtes dhe të integrimit në regjionin e Schaffhausen-it*

NDËRKUPTIMI DHE INTEGRIMI



12

DËSHMI GJUHE DHE CERTIFIKATA GJUHËSORE

Në Zvicër, me marrjen e lejeve të ndryshme të qëndrimit janë të lidhura aftësi përkatëse gjuhësore. Edhe për formimet profesionale dhe të mëtejshëm ose aktivitete profesionale mund të përcaktohen aftësitë gjuhësore të nevojshme për këtë. Këto duhet të vërtetohen me një certifikatë gjuhësore. Një fletëshpjegim për këtë mund të gjendet në faqen e internetit të "Integres".

- *fide – Deutsch in der Schweiz – lernen, lehren, beurteilen: Me "fide" jeta e përditshme në Zvicër vendoset në fokus gjatë promovimit dhe vlerësimit të aftësive gjuhësore. fide orientohet në kornizën e përbashkët evropiane të referimit për gjuhët (GER) dhe synon t'i aftësojë migrantet dhe migrantët që të përballojnë situata specifike të jetës nga ana gjuhësore.*
- *Sekretariati i Shtetit për Migrim (Staatssekretariat für Migration SEM) – Certifikatë gjuhësore: Listë me certifikata gjuhësore që njihen: Të gjitha certifikatat gjuhësore, të cilat janë në këtë listë, janë të vlefshme për lejen e qëndrimit (B), lejen e përhershme të qëndrimit (C) dhe marrjen e nënshtetësisë.*

INTERKULTURELLE VERSTÄNDIGUNG

Biseda e përbashkët është kushti paraprak vendimtar për një bashkëpunim të mirë. Përkthimi interkulturore shkon përtej një përkthimi me fjalë. Ai mundëson që me gjithë prejardhjen dhe kulturën e ndryshme të ndërkuptohe mbi parafytyrimet e vlerave dhe këndvështrimit vetjak të një situate. Siguria e përfutur nëpërmjet kësaj zgjeron hapësirën e veprimit të të gjithë pjesëmarrësve dhe lehtëson përpunimin e rrugëzgjdhjeve në partneritet. Vendi i specializuar „Derman“ ndërmjetësor shërbime të përkthimit me gojë, të përkthimit telefonik, të shoqërimit dhe të përkthimit me shkrim dhe shoqëron profesionalisht shërbimet. Vendi i specializuar është i arritshëm nga e hëna deri të premten gjatë orëve zyrtare ose nëpërmjet e-mailit dhe formularit të aplikimit në faqen e internetit. Jashtë këtyre orëve të hapjes shërbimi i përkthimit telefonik i

Organizatës së Azilit të Cyrihut (aoz) brenda pak minutash vë në dispozicion, përgjatë 24 orësh në 365 ditë në vit, përkthyes profesionistë në mbi 50 gjuhë.

- *SAH Schaffhausen – Të përkthyerit me gojë: Ndërmjetësimi dhe formimi i përkthimit ndërkulturore me gojë dhe shoqërimi - Vënie në punë në vend, nëpërmjet telefonit ose me shkrim.*
- *Shërbimi i përkthimit telefonik aoz: Ndërmjetësimi i përkthyesve në 365 ditë në vit, brenda 24 orësh, nën numrin 0842 442 442.*

INFORMACIONI LEHTËSON NDËRKUPTIMIN

Shumë informacione mbi kantonin e Schaffhausen-it ju mund t'i merrni nga interneti ose nga mediat. Në veçanti gazetatat lokale ju japin juve informacione për jetën në regjion. Ju gjeni atje shpallje për vende pune dhe bane-sa, këshilla për aktivitete si dhe adresa të vlefshme. Informacione për ngjarjet më të rëndësishme në regjion ju i gjeni në faqen e internetit të kantonit të Schaffhausen-it dhe të komunave.

MEDIAT REGJIONALE

- **Gazetat e Schaffhausen-it:**
Klettgauer Bote (Lajmëtari i Klettgauer-it)
Schaffhauser Bock (Dashi i Schaffhausen-it)
Schaffhauser AZ (Gazeta e punëtorëve të Schaffhausen-it)
Schaffhauser Nachrichten (Lajmet e Schaffhausen-it)
Steiner Anzeiger
Thaynger Anzeiger
- **Radiostacione regjionale:**
Radio Munot (Radio Munoti)
Radio Rasa (Radio Raza)
Radio Top – Schaffhausen
Schweizer Radio SRF (Radiostacioni Zvicra) – Regionaljournal Zürich/Schaffhausen (Gazetari regjionale Cyrih/Schaffhausen)
- **Stacione televizive regjionale:**
Schaffhauser Fernsehen (Televizioni i Schaffhausen-it)
Tele D (Tele[vizioni] D)
Tele Top News Schaffhausen
- **Platforma online schaffhausen.ch:**
Informacione për kulturë, kohë të lirë, punë, banim, dhe shumë më tepër.



TË GJENDET NJË BANESË

Për të gjetur një banesë, si me qira ashtu edhe për ta blerë, përshtatet mënyra e mëposhtme e të vepruarit:

- të kalohen nëpër duar shpalljet në gazetatat lokale;
- të pyeten të njohur për banesa që do të lirohen;
- t'i drejtohet një administrate për pasuritë e paluajtshme;
- të konsultohet një nga faqet e shumta të specializuara të internetit për pasuritë e paluajtshme.

► *schaffhausen.ch: Informacione regjionale ndër të tjera për tregun e banimit.*

- *Lidhja e qiramarrësve e kantonit Schaffhausen (Mieterverband Kanton Schaffhausen): Këshillim ligjor në rast të pyetjeve për qiranë. Fletëpalosje të dobishme për tema të ndryshme, si p.sh. kostot shtesë. Për anëtarët këshillimi është falas; Pranimi me efekt të menjëhershëm është i mundur.*
- *Zyra e pajtimit për punët e qirave në Schaffhausen (Schlichtungsstelle für Mietsachen Schaffhausen): Autoriteti i pajtimit për mosmarrëveshjet nga qiramarrja dhe qiramarrja me koncesion e hapësirave të banimit dhe biznesit.*
- *Kantoni i Schaffhausen-it – Zyra e zbatimit të detyrueshëm dhe konkursit (Betreibungs- und Konkursamt): Ekstrakti nga regjistri i zbatimit të detyrueshëm mund të kërkohet online.*

QIRAJA

Kush interesohet për një banesë, mbush, si rregull, një formular regjistrimi. Atje jepen për shembull moshja, gjendja civile, profesioni, fëmijët, statusi i qëndrimit, punëdhënësi, rroga, kafshët shtëpiake. Për të vërtetuar, që dikush mund ta paguajë qiranë, është i nevojshëm një ekstrakt nga regjistri i zbatimit të detyrueshëm. Ky dokument duhet të merret në zyrën e zbatimit të detyrueshëm të kantonit të Schaffhausen-it ose në vendbanimin e fundit tuaj (jashtë kantonit të Schaffhausen-it).

Në një kontratë të qirasë përkasin, në rastet më të shumta, edhe kushtet e përgjithshme dhe rregullorja e shtëpisë. Qiramarrësit dhe qiramarrëset duhet të paguajnë në shumicën e rasteve para hyrjes në banesë një depozitë të përqindjes së qirasë (shumë garancie), e cila paguhet sërish pas prishjes së marrëdhënieve të qirasë. Si alternativë ka ofruar, të cilët garantojnë për një premi vjetore tek qiradhënësi. Kështu, paratë nuk mbeten të blokuara gjatë marrëdhënieve të qirasë. Pagesa e qirasë është, si rregull, e detyrueshme në fillim të muajit. Krahas qirasë duhet të paguhet përveç kësaj edhe kostot shtesë (ngrohja, uji i ngrohtë etj.). Nëse në kontratë nuk janë shënuar kosto shtesë, informohuni gjatë qiramarrjes për kostot e detajuara.

INFRASTRUKTURA

Për telefon, internet dhe televizion kabllor ka ofruar të ndryshëm. Cilat oferta mund të përdoren varet nga rajoni ose vendi ku ju banoni. Shërbimet dhe çmimet janë të ndryshme, ia vlen një krahasim. Kush dëshiron të vendosë një parabolë satelitësh, fillimisht duhet ta sqarojë këtë me qiradhënësin ose të informohet tek fqinjët dhe fqinjët. Qasje publike në internet ekziston, për shembull, në Bibliotekën e Qytetit të Schaffhausen-it. Tensioni i rrjetit është 230 volt. Përshtatës për prizat mund të merren në tregun e specializuar.

SIGURIMI PËR ORENDITË SHTËPIAKE DHE PËR PËRGJEGJËSINË LIGJORE

Është i këshillueshëm të lidhet një sigurim për orënditë shtëpiake dhe për përgjegjësinë ligjore. Në rast të disa kontratave të qirasë këto janë madje të detyrueshme. Disa sigurime mbajnë përgjegjësi për disa dëme. Për shembull, nëse një vaskë derdhet dhe çon në një dëm uji ose nëse ka një çarje të sendeve të larjes.

► *Zyra Federale për Strehim (Bundesamt für Wohnungswesen BWO – «Banimi në Zvicër»): Fletë informacioni me informacione qendrore rreth të banuarit. Mund të merret në gjuhë të ndryshme.*



14

BASHKËJETESA NË NJË SHTËPI ME SHUMË FAMILJE

Me qëllim që bashkëjetesa në një shtëpi me qira të funksionojë mirë, duhet që të gjithë qiramarrëset dhe qiramarrësit të marrin parasysh njëri-tjetrin. Në rregulloren e shtëpisë janë të përbajtura në rastet më të shumta pikat kryesore.

Kohët e qetësisë

Qetësia e natës zgjat si rregull nga ora 22 deri në orën 7, qetësia e drekës nga ora 12 deri në orën 13. Edhe në ditët e diela dhe ato të festave duhet të shmangët zhurma. Parimisht duhet që televizori dhe aparatet muzikore në banesë të vendosen në volumin e dhomës. Kush do të festojë një festë, ia njofton këtë më mirë fqinjëve të tij paraprakisht.

Hapësirat e përbashkëta

Hyrja, hapësira e shkallëve, kuzhina për larje, vendet e parkimit e kështu me radhë, janë në dispozicion të të gjithë qiramarrësve. Është e rëndësishme, të mos bllokohen këto vende të përdorura bashkërisht dhe të kujdeset për pastërti. Në shumë shtëpi është e rregulluar veçanërisht, kush dhe kur mund ta përdorë kuzhinën e larjes. Në rastet më të shumta është e ndaluar pirja e cigares në hapësirën e shkallëve ose në ashensor respektivisht në hapësirat e përbashkëta.

Nëse shfaqen probleme

Prishet diçka, drejtojeni mirëmbajtjes së shtëpisë ose qiradhënësit / administratës së pasurive të paluajtshme. Veçanërisht në shtëpitë më të mëdha është mirëmbajtësja e shtëpisë, për riparime të vogla, por edhe për sigurinë dhe mirëmbajtjen, atje. Riparime të thjeshta ose pastrime duhet t'i ndërmarrë dhe t'i paguajë vetë qiramarrësi ose qiramarrësja. Për shembull nëse bëhet fjalë për këtë, që të zëvendësohet filtri në thithjen e avullit, një llamarinë për pjekje ose një zorrë për dushin.

Nëse shfaqen vështirësi me fqinjët dhe nuk mjafton më dialogu, ju mund të kërkonit një bisedë me mirëmbajtjen e shtëpisë ose me administratën. Nëse nuk mund të gjenet asnjë zgjidhje, ju mund të drejtoheni tek Zyra e pajtimit për punët e qirave ose tek Shoqata e qiramarrësve.

PRONË PRIVATE BANIMI

Blerja e tokës për ndërtim dhe e banesave private nëpërmjet personave të huaj iu nënshtrohet përkufizimeve të caktuara. Për blerjen e banesave private për vendbanimin vetjak ju nuk keni nevojë për asnjë lejë. Mbi rregullat, të cilat duhet të merren parasysh në rast të blerjes së tokave ose të banesave private, ju orienton hipoteka kantonale ose sekseri për pasuritë e paluajtshme. Në lidhjen e pronarëve të shtëpive ose shoqatës Casafair ju merrni informacione rreth zotërimit të një shtëpie, kini mundësinë të lini të këshilloheni ligjërisht ose të merrni informacione për banimin pajtueshëm me mjedisin.

HYRJA NË MEDIAT

Lidhja e telefonit dhe internetit

Zvicra disponon një rrjet të zgjeruar mirë të telekomunikacionit. Hyrjet në telefon dhe internet janë praktikisht të garantuara kudo. Për një lidhje telefoni dhe interneti ju duhet të regjistroheni tek një ofrues.

Radioja dhe televizori

Marrja e programeve të radios dhe televizorit është me detyrim pagese. Kjo pagesë merret nga „Serafe“. Parimisht të gjitha ekonomitë shtëpiake në Zvicër kanë detyrim takse, pavarësisht nëse janë në posedim të një pajisjeje apo jo.



EKONOMIA SHTËPIAKE DHE MBROJTJA E MJEDISIT

Me heqjen e drejtë të mbeturinave ne japim një kontribut për mbrojtjen e mjedisit tonë. Komunitat tuaja ju informojnë juve mbi heqjen e mbeturinave në përshtatje me mjedisin dhe ju japin informacione mbi vendet e grumbullimit, ditët e grumbullimit dhe më tepër. Financimi pason nga taksat për mbeturinat. Ajo përbëhet nga një taksë bazë dhe një për sasinë. Lëndë me vlerë mund të jepen falas në vendet e grumbullimit.

Mbeturinat shtëpiake

Transportimi i mbeturinave shtëpiake është në të gjitha komunitet e kantonit me detyrim pagese. Qeset ose pullat me pagesë mund të merren në administratat komunale, në zyrat e postës dhe në dyqane të ndryshme shitjeje.

Mbeturinat e gjelbra

Në komunitet të ndryshme mbeturinat organike (mbeturinat e gjelbra) mund të hiqen të ndara nga mbeturinat e tjera shtëpiake pa taksa.

Qelqi, kutitë prej metali (llamarinë e bardhë), PET, alumini dhe vaji ushqimor

Heqja e qelqit, kutive të metalit, shishe pijesh prej PET, aluminit dhe e vajit ushqimor duhet të pasojë mbi vendet e grumbullimit me kontejner ose në tregtinë e detajuar. Ju gjeni në dokumentet e komunës informacione të detajuara edhe mbi heqjen e mbeturinave kaba, kimikateve, tekstileve e kështu me radhë.

Letra dhe kartoni

Letër e vjetër dhe karton grumbullohen periodikisht ose mund të jepen në sheshet e emëruara për heqje. Terminat e grumbullimit ndodhen gjithashtu në dokumentet e komunës përkatëse ose në shtypin ditor.

Bateritë

Për të gjitha bateritë, akumulatorët dhe bateritë e makinave vlen në Zvicër detyrimi i dhënies mbrapa i përdoruesve dhe detyrimi i marrjes mbrapa i tregtarëve. Bateritë e aparateve mund të jepen mbrapa pothuajse në të gjitha dyqanet e shitjes.

Aparate elektrike dhe elektronike

Të gjithë aparatet që punojnë elektrikisht duke përfshirë pajisjet plotësuese mund të jepen për heqjen në vendet e shitjes së aparateve të të njëjtit lloj. Edhe pa blerje të re dhe pavarësisht nga marka, marrja mbrapa është falas.

- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Laboratori ndërkantonal: Informacione për heqjen e të gjitha mbeturinave.*
- ▶ *Enti Federal për Mjedisin (Bundesamt für Umwelt BAFU): Udhërrëfyesi për mbeturinat dhe informacione të përgjithshme për heqjen e mbeturinave.*



16

QARKULLIMI I NGADALSHËM: UDHËTIMI MË KËMBË OSE ME BIÇIKLETË

Biçikleta respektivisht „velo“ është në Zvicër një mjet i pëlqyer për lëvizjen. Rrugët e biçikletës janë të pajisura mirë me tabela ose të shënuara me ngjyrë të verdhë, me qëllim që drejtuesit e biçikletave të lëvizin të sigurt në qarkullimin rrugor. Këshillohet të lidhet një sigurim për përgjegjësinë ligjore, i cili ju siguron juve në rast dëmshme me biçikletë kundrejt të tretësh. Për biçikleta elektrike (E-Bike) vlejnë rregulla shtesë.

Edhe kush udhëton më këmbë do të duhej të ecë mundësisht i sigurt nëpërmjet qarkullimit. Këmbësore dhe këmbësorë kanë parimisht përparësi në kalimet për këmbësorët. Fëmijë, të cilët rrugën e tyre të shkollës e bëjnë më këmbë, bëhen nëpërmjet kësaj më të pavarur, kanë kontakte sociale dhe lëvizin kështu çdo ditë. Prandaj policia e qarkullimit të Schaffhausen-it i mëson fëmijët e kopshtit të fëmijëve dhe nxënësit e nxënësët për sjelljen e drejtë në qarkullim.

- ▶ „Qarkullimi më këmbë në Zvicër“: „Qarkullimi më këmbë në Zvicër“ kujdeset për çështjet e këmbësorëve dhe këmbësoreve dhe angazhohet për një planifikim qarkullimi në pajtueshmëri me këmbësorët.
- ▶ „Pro Velo Schaffhausen“: „Pro Velo“ angazhohet për këtë, që të nxitet biçikleta si mjet i shëndetshëm lëvizjeje, me plot kënaqësi dhe i pajtueshëm me mjedisin në regjionin e Schaffhausen-it. Në faqen e internetit ju gjeni shumë këshilla të dobishme për drejtimin e biçikletës në regjion. „Pro Velo Schaffhausen“ organizon bursën për biçikleta dhe kurset e drejtimit.
- ▶ „Zvicra mobil“: Rrjeti Nacional për Qarkullimin e Ngadalshëm. Në faqen e internetit mund të kërkohen dhe të planifikohen online për shembull rrugë për biçikletë (Veloland), rrugë ecjeje më këmbë etj.
- ▶ Schulweg bildet: Rekomandime për prindër, si mund t'ua mundësojnë ata fëmijëve të tyre rrugën e pavarur dhe të sigurt për në shkollë pa taksë prindërisht.

QARKULLIMI PUBLIK

Në Zvicër ju qëndron në dispozicion një rrjet qarkullimi publik i zgjeruar mirë dhe i efektshëm, i cili i lidh edhe komunat e vogla. Planet e udhëtimit të trenit, autobusit dhe udhëtimet e anijeve janë të përshtatura ndaj njëri-tjetrit. Pikërisht për distanca të gjata dhe për të shkuar e ardhur në punë ose shkollë preferohet nga shumë udhëtarë treni. Ka oferta të ndryshme dhe abonime të ndryshme me të cilat ju mund ta përdorni me çmim të leverdishëm qarkullimin publik. I pëlqyeshëm është veçanërisht abonimi gjysmë takse, me të cilin lejohet të përdoret qarkullimi publik me gjysmën e çmimit. Fëmijë nën 6 vjet udhëtojnë falas. Fëmijë më të rritur deri në 16 vjet mund të udhëtojnë falas me kartën për të rinj në shoqërim të prindërve ose me kartën e bashkëudhëtimit për fëmijë në shoqërim të një personi tjetër të rritur shoqëruar. Tek disa komuna ju mund të tërhiqni leverdishëm bileta ditore për gjithë Zvicrën.

- ▶ *Schweizerische Bundesbahnen (SBB) : Informacione për abonime dhe ulje çmimi biletash si dhe planet e udhëtimit në linjë (online) për gjithë Evropën.*

Qarkullimi regional në Schaffhausen

Kush, në Schaffhausen, do të shkojë nga fshati në qytet (dhe anasjelltas), e arrin pikësynimin e tij në një kohë të shkurtër. Lidhje me autobus dhe tren ekzistojnë në çdo komunë. Kush dëshiron të udhëtojë disi më soditës, atij i qëndrojnë në dispozicion lidhje të ndryshme udhëtimesh me anije mbi Ren. Regjioni i Schaffhausen-it i është bashkuar lidhjes tarifore OSTWIND. Në këtë lidhje tarifore vlen një tarifë zonash, me këtë pasagjeri mund të udhëtojë brenda kohëzgjatjes së vlefshmërisë me një biletë të vetme udhëtimiti në të gjitha linjat e zonave të zhvlefësuar. Kështu gjatë ndërrimit nga një tren në një linjë autobusi nuk duhet të blihet asnjë biletë tjetër, nëse zona përkatëse tanimë është zhvlefësuar.



- ▶ *Ndërmarrjet e qarkullimit të Schaffhausen-it (Verkehrsbetriebe Schaffhausen VBSH): Informacione për mbi planet qytetare dhe regionale të udhëtimit si dhe mbi biletat dhe abonimet në lidhjen tarifore OSTWIND.*
- ▶ *Shoqëria zvicerane e udhëtimit me anije „Untersee dhe Reni“ (Schweizerische Schifffahrtsgesellschaft Untersee und Rhein): Planet e udhëtimeve dhe propozime ekskursionesh*
- ▶ *Shoqëria federale zvicerane e trenave (Schweizerische Bundesbahnen SBB): Udhëtimi me lëvizshmëri të kufizuar: Informacione dhe oferta për udhëtimin pa pengesa për njerëz me lëvizshmëri të kufizuar.*

Kush në anë të kundërt e ka një vendbanim që prej një viti në Zvicër, duhet ta regjistrojë një automjet të importuar në Zvicër. Të gjithë automjetet me motor dhe rimorkio duhet të kontrollohen zyrtarisht para lejimit të tyre në qarkullimin zviceran. Informohuni me kohë pranë zyrës kantonale të qarkullimit mbi përcaktimet e lejimit dhe dokumentet e nevojshme.

- ▶ *Kantoni Schaffhausen – Zyra e qarkullimit rrugor dhe udhëtimeve me anije (Strassenverkehrs- und Schifffahrtsamt): Informacione për patentën, sigurinë në qarkullim, etj.*

DREJTIMI I AUTOMJETIT NË ZVICËR

Patenta dhe siguria në qarkullim

Patentat e huaja janë në Zvicër të vlefshme një vit që nga data e hyrjes. Brenda këtij afati duhet të bëhet kërkesë për një patentë zvicerane pranë zyrës kantonale të qarkullimit rrugor dhe udhëtimeve me anije. Informohuni për rregullat e vlefshme të qarkullimit në Zvicër!

Detyrimi për vinjetë

Për udhëtimin në autostradë dhe rrugëve automobilistike ekziston një detyrim për vinjetë. Vinjeta mund të blihet në pikat doganore, zyrat e postës, pikat e karburantit, në garazhet dhe kancelaritë e „TCS“ si dhe në zyrat kantonale të qarkullimit rrugor.

Sigurimi për automjete me motor

Për të gjitha automjetet me motor si makinat, motorët, biçikletat me motor dhe biçikletë elektrike deri në 45km/h, si dhe për anijet është një sigurim për përgjegjësinë ligjore i detyruar. Sigurimi i automjeteve me motor mund të zgjerohet me shtesa të tjera.

Importimi i automjeteve të huaja në Zvicër

Nëse ju hyni duke udhëtuar në Zvicër dhe importoni një automjet nga jashtë shtetit, njoftoheni menjëherë automjetin në doganën zvicerane. Automjetet nuk duhet të regjistrohen në dymbëdhjetë muajt e parë që prej hyrjes suaj në Zvicër, nëse targa e huaja janë të vlefshme dhe nëse ekziston një garanci nga sigurimi.

QARKULLIMI AJROR

Aeroporti internacional Zyrih-Kloten është afër dhe i aritshëm shpejt. Me makinë nevojiten deri në aeroport rreth 30 minuta, me lidhjen direkte të trenit 40 minuta. Praktikisht fluturohet çdo metropol ekonomik nisur nga Cyrihu çdo ditë. Aeroporti vetë është i lidhur mirë me mjetet e qarkullimit publik. Regjistrimi (Einchecken) është i mundur direkt në stacionin e trenit në Schaffhausen. Atje ju merrni edhe një biletë për në bord.

UDHËTIM JASHTË KUFIRIT- DISPOZITAT DOGANORE

Jashtë shteti i afërt fton për ekskursione. Mendoni që ju do të mbikaloni një kufij shteti dhe që duhet të keni me vete dokumentet e përshtatshme. Informacione në lidhje me dispozitat ligjore ju merrni pranë zyrës zvicerane të doganës.

- ▶ *Zyra Federale për doganë dhe siguri kufitare (Bundesamt für Zoll und Grenzsicherheit BAZG): Informacione të administratës doganore konfederative për privatë dhe firma.*

TË GJENDET NJË VEND PUNË

Hyrja në tregun e punës është e rregulluar ligjërisht dhe varet nga statusi i qëndrimit. Për të gjetur një punë, është i këshillueshëm një kombinim i metodave të ndryshme të kërkimit:

- të kërkohet në internet për shpallje vendesh pune;
- përdorimi i platformës qendrore
- të dërgohen kërkesa spontane në ndërmarrje;
- të merret kontakt me zyrat për ndërmjetësimin e vendeve të punës;
- të bisedohet me persona nga rrethi juaj;
- të bëhet një kërkesë në ofertat për vende pune në gazetë;
- njoftohuni tek qendra regjionale për ndërmjetësim pune (RAV).

- Qendra për ndërmjetësim pune (Arbeitsvermittlungszentrum RAV) Schaffhausen: Kompetenecat e Qendrës rajonale për ndërmjetësim pune qëndrojnë falas në dispozicion për persona punëkërkues me vendbanim në kantonin e Schaffhausen-it.

SI TË APLIKOJ UNË NË ZVICËR?

Në Zvicër, në një aplikim bëjnë pjesë një biografi dhe një letër motivimi. Të rëndësishme për aplikimin janë edhe dëshmitë e punës dhe vërtetime pune, certifikata mbi formimin profesional si dhe diploma, të cilat i bashkëngjiten dosjes. Shpesh aplikimet duhet të paraqiten online. Këshilla të vlefshme për përgatitjen e një dosjeje aplikimi ju merrni në internet.

- Qendra e informacionit për profesionin (Berufsinformationszentrum BIZ) Schaffhausen - Këshillim karriere për të rritur: Në këshillimin për karrierën ju sqaroni gjendjen tuaj fillestare dhe zhvillonin ide për synime të mundshme profesionale si dhe formimet profesionale ose të mëtejshme.
- berufsberatung.ch: Informacione të përgjithshme për vende mësimi, profesionit dhe punë, këshilla për kërkesat për vende pune etj. Dokumente të përkthyer në shumë gjuhë.

- Shoqata pika e takimit e të papunëve Schaffhausen (Verein Erwerbslosentreffpunkt Schaffhausen VETS) – Dhoma e shkrimit: Ndihmë në rast të përgatitjes së biografisë dhe të aplikimit.
- arbeit.swiss: Portali qendror për punëkërkues, punëdhënës dhe ndërmjetësues pune.

NJOHJA E DIPLOMAVE TË HUAJA

Diploma dhe formime profesionale të ndryshme mund të njihen në Zvicër. Në varësi të përfundimit [të shkollës] të kualifikimit, drejtohuni në vendet e mëposhtme:

- Sekretariati i shtetit për arsim, kërkime shkencore dhe novacion (Staatssekretariat für Bildung, Forschung und Innovation SBFI): Koordinimi i njohjes së diplomave të huaja.
- Konferenca zvicerane drejtorët kantonale të edukimit – Diploma të huaja: Njohja e profesionit në fushën e edukimit
- Swissuniversities: Informacione mbi kushtet e lejimit në universitetet zvicerane.

PAGA DHE KONTRIBUTET SOCIALE

Në Zvicër janë rrogat bruto relativisht të larta, kjo vlen edhe për kostot e jetesës. Nuk ka një rrogë minimale të vlefshme për të gjithë sektorët. Disa degë njohin megjithatë rroga minimale të marrëveshjes kolektive të punës. Nga paga hiqen kontributet e detyruara për sigurimin e pleqërisë dhe të pasjetuarve (AHV), sigurimin për invaliditet (IV), sigurimin për papunësi (ALV) dhe për sigurimin ndaj aksidenteve. Në kantonin e Schaffhausen-it paguajnë punëmarrës dhe punëdhënës, përveç kësaj, një kontribut në fondin social kantonal. Nga të ardhura vjetore prej rreth 20'000 franga hiqen kontribute shtesë për përkujdesjen profesionale (të ashtuquajturën shtylla e 2-të) si një plotësim i AHV. Heqjet për sigurimet e detyrueshme sociale përbëjnë gjithsej rreth 15- 20% të të ardhurave.

- Enti Federal për Sigurimet Sociale (Bundesamt für Sozialversicherungen BSV): Kuotat e kontributeve.



HUMBJA E PUNËS

Kush banon në Zvicër dhe si punëmarrëse ose punëmar-rës mbetet pa punë, ka të drejtë - në rast se kushtet e nevojshme paraprake janë të përmbushura - për pagesat e sigurimeve, të ashtuquajtur të holla ditore të papunë-sisë. Një lejë e vlefshme qëndrimi si dhe një punësim për të paktën 12 muaj gjatë dy viteve të fundit para njoftimit janë kushtet qendrore për transferimin e të holla ditore të papunësisë. Nëse ju, pas përfundimit të një marrëdhënieje pune, nuk gjeni menjëherë punë përsëri, ju duhet menjëherë, më së miri madje gjatë afatit të prishjes së kontratës, të njoftoheni pranë qendrës regjionale për ndërmjetësim pune (RAV). Atje ju merrni informacione në lidhje me hapat e tjerë, të cilat ju duhet të ndërmerrni.

- ▶ *Kantori i Schaffhausen-it – Zyra e Punës: Këshillime në rast të papunësisë, ndërmjetësim vendesh pune, pikë kontakti për lejë pune për të huaj dhe të huaja, pyetje të tjera rreth temës së punës në Zvicër.*
- ▶ *Qendra regjionale për ndërmjetësim pune (Regionales Arbeitsvermittlungszentrum RAV): Qendra e shërbimit për punëkërkuar dhe punëdhënës.*

KUSHTET E PUNËS

Zvicra është e njohur për kushtet e saj të mira të punës. Sipas profesionit dhe degëve këto janë megjithatë të përcaktuara ndryshe. Informohuni me kohë mbi kushtet e vlefshme të punës. Në kontratën e punës përcaktohen lloji i punës që duhet të kryhet, kohët e punës, koha e provës, afati i prishjes së kontratës, pushimet, rroga, detyrimi i përgjegjësisë profesionale dhe arka e pensionit. Në degë të caktuara ekzistojnë marrëveshje kolektive pune (GAV) Një marrëveshje kolektive pune (GAV) është një marrëveshje me shkrim ndërmjet punëdhënësve të veçantë ose disa prej tyre ose lidhjeve të tyre profesionale dhe sindikatave. Ajo përmban dispozita mbi kushtet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve si dhe dispozita, të cilat drejtohen në palët kontraktuese të „GVA“-së.

- ▶ *Sekretariati i shtetit për ekonominë (Staatssekretariat für Wirtschaft SECO): Informacione përreth temës punë.*
- ▶ *Sekretariati i Shtetit për Migrim (Staatssekretariat für Migration SEM): Informacione për forca të huaja të punës lidhur me ushtrimin e një veprimtarie pune në Zvicër.*
- ▶ *Kantori i Schaffhausen-it – Inspektorati i punës: Inspektorati i punës është qendra e këshillimit, shërbimit, kompetencës dhe e zbatimit për sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit në vendin e punës, si dhe për kohët e punës dhe të qetësisë.*

19

MBROJTJA NGA PRISHJA E KONTRATËS SË PUNËS

Ligji mbron të punësuarit, në rast sëmundjeje, aksidenti, shtatzënie ose lehonie, nga prishja e kontratës. Një prishje kontrate gjatë kësaj hapësire kohore është si rregull e pavlefshme. Në rast të një prishje keqpërdoruese kontrate për arsye të tjera, i punësuarit ose e punësuar nga ana tjetër nuk duhet të integrohet përsëri në ndërmarrje; mund të bëhet i vlefshëm vetëm një zhdëmtim para gjyqit.

- ▶ *Sekretariati i punës (Arbeitersekretariat) Schaffhausen: Këshillim juridik, Këshillim fillestar falas*

PUNË NË TË ZEZË

Edhe dikush, i cili paguhet për punë të herëpashershme në fushën e pastrimit, përkujdesjes së fëmijëve, punëve të shtëpisë dhe të kopshtit, vlen si me veprimtari pune. Ai ose ajo duhet të jenë në zotërim të një leje sipas së drejtës për të huajt dhe të jetë i regjistruar tek sigurimet sociale (ose të regjistrohet vetë), ndryshe bëhet fjalë për punë ilegale ose për punë të zezë. Personi, i cili punon në të zezë, nuk është i siguruar në rast të invaliditetit, aksidentit ose papunësisë. Pasojat mund të jenë dramatike. Qëndron pra në interesin e punëmarrësve të jenë të regjistruar.

- ▶ *Sekretariati i shtetit për ekonominë (Staatssekretariat für Wirtschaft SECO): Informacione për temën puna në të zezë, dhënie ndihme për të dalë nga puna në të zezë, oferta kontakti.*
- ▶ *Kantori i Schaffhausen-it – Puna në të zezë: Informacione për punën në të zezë.*

SIGURIA SOCIALE



20

PËRKUJDESJA NË ZVICËR

Rrjeti i dendur prej sigurimesh sociale dhe ndihmave sociale publike mbron njerëzit që punojnë dhe jetojnë këtu dhe të afërmit e tyre nga pasojat ekonomike të sëmundjeve, aksidenteve, papunësisë, invaliditetit dhe rreziqeve të tjera. Pikësynimi është të pengohet varfëria në Zvicër. Siguria sociale është një pikëmbështetje e sistemit shtetëror zviceran. Në plan të parë qëndrojnë përgjegjësia vetjake dhe puna. Siguria sociale në Zvicër bazohet mbi parimin e 3 shtyllave (shih grafikën) si dhe ndihmën sociale.

Ato sigurojnë bazën e ekzistencës, nëse ju ose një nga të afërmit tuaj bini në shtrëngesa financiare nëpërmjet

paafësisë për veprimtari pune, papunësisë ose vdekjes. Përveç kësaj është i siguruar një pension në pleqëri. Nëse ju bini në një gjendje të vështirë sociale, ju mund të kërkonit ndihmë. Informacione për këtë ju merrni në komunën e banimit dhe pranë zyrës së sigurimit social në Schaffhausen.

- Zyra e sigurimit social (Sozialversicherungsamt SVA) Schaffhausen: Informacione dhe formularë aplikimi për Sigurimet Sociale dhe për reduktimin e primeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.
- Enti Federal për Sigurimet Sociale (Bundesamt für Sozialversicherungen BSV): Informacione mbi sigurimet e ndryshme sociale për të ardhur dhe emigrantë.

Përkujdesja në Zvicër

Shtylla e 1-rë		Shtylla e 2-të		Shtylla e 3-të	
Përkujdesja shtetërore		Përkujdesja profesionale		Përkujdesja private	
Sigurimi i ekzistencës		Vazhdimi i standardit të zakonshëm të jetës		Plotësime individuale	
„AHV“ Sigurimi i pleqërisë dhe i të pasjetuarve „IV“ Sigurimin për invaliditet	„EL“ Pagesa shtesë „EO“ Rregullorja e shpërblimit pas humbjes së të ardhurave	„BVG“ Përkujdesja e detyruar profesionale	Shtylla 2b Përkujdesja e mbide tyruar profesionale	Shtylla 3a Përkujdesja e lidhur me kushte	Shtylla 3b Përkujdesja vullnetare

Përkujdesja për pleqërinë, vdekjen dhe invaliditetin ndërtohet mbi tre shtylla:

1. Shtylla: „AHV/IV/EO“ është sigurimi bazë. Të gjithë personat, të cilët jetojnë dhe/ose punojnë në Zvicër, janë të siguruar detyrimisht.

2. Shtylla: Në përkujdesjen profesionale (arka e pensionit) janë të siguruar detyrimisht të gjithë punëmarrësit që nga një e ardhur e caktuar vjetore.

3. Shtylla: Përkujdesja private është vullnetare dhe financohet me të holla personale të kursyera.



„AHV“ dhe „IV“

Sigurimi më i rëndësishëm është sigurimi i pleqërisë dhe i të pasjetuarve (AHV). Parimisht të gjithë personat banues në Zvicër i nënshtrohen „AHV“-ut, pavarësisht nga kjo, nëse ata janë të një nacionaliteti zviceran ose të huaj, me veprimtari pune ose pa veprimtari pune. Mbi moshën e rregullt të pensionit informon Zyra e sigurimit social Schaffhausen. Është e mundur të dilet para kohe në pension, atëherë pensioni do të shkurtohet. Kontributet për sigurimin ndaj invaliditetit (IV) hiqen, së bashku me kontributet për „AHV“, nga rroga. Në rast invaliditeti sigurimi jep të drejtë për një mbështetje në rast të ripërfshirjes në tregun e punës ose për një pension. Nëse ju nuk jeni i punësuar ose jeni zënë me punë si të vetëpunësuar, ju duhet t'i paguani kontributet direkt në arkën e kompensimit.

- ▶ *Pro Senectute Kanton Schaffhausen: Këshillim social për njerëz të moshuar dhe të afërmit e tyre.*
- ▶ *Pro Infirmis Schaffhausen: Këshillime dhe mbështetje për njerëz me një aftësi të kufizuar dhe për të afërmit e tyre, deri në arritjen e moshës së „AHV“.*

Shpërblimi gjatë barrë-lindjes

Pas lindjes gratë me veprimtari pune kanë pretendim për një pushim barrë-lindjeje prej të paktën 14 javësh. Në këtë kohë ato marrin si rregull 80 % të rrogës së tyre. Për këtë ju duhet të keni qenë gjatë 9 muajve para lindjes të siguruara dhe të keni punuar gjatë shtatzënisë të paktën 5 muaj. Informacione të detajuara ju merrni pranë zyrës së sigurimit social.

Leja e atësisë

Në gjashtë muajt e parë pas lindjes së fëmijës, baballarë me veprimtari pune kanë të drejtë për lejen e atësisë prej dy javësh (maksimumi 14 të holla ditore).

Përkujdesja profesionale BV/ Arka pensionale

Punëmarrës në Zvicër, që nga të ardhura vjetore të caktuara, duhet t'i bashkohen institucioneve të përkujdesjes profesionale të punëdhënësit. Kontributi është ndërmjet 7% deri në 18 % të të ardhurave vjetore. Të paktën gjysma e këtyre primeve duhet të paguhen prej punëdhënësit. Të zënë me punë si të vetëpunësuar nuk i nënshtrohen këtij ligji.

Shtesat familjare

Në Zvicër punëmarrësit si edhe të zënë me punë si të vetëpunësuar dhe jo të zënë me punë kanë pretendim për shtesa familjare. Për fëmijë me vendbanim jashtë shtetit mund të dalin shtesa me reduktim. Pretendim për shtesa për fëmijë ekziston për fëmijë nga dita e parë e muajit të lindjes deri në fund të muajit, në të cilin atë përfundojnë vitin e 16-të të jetës. Për fëmijë në formim profesional shtesat jepen deri në përfundimin e formimit profesional, megjithatë më së gjati deri në përfundimin e vitit të 25-të të jetës.

NDIHMA SOCIALE

Ndihma sociale ka për detyrë, ta largojë, lehtësojë ose ta mënjanojë gjendjen e vështirë materiale dhe personale të njerëzve. Ju keni të drejtë për ndihmë sociale nëse ju ndodheni në një gjendje të ngushtë personale, nëse nuk keni para të mjaftueshme për të mbajtur veten ose për të paguar mbajtjen e familjes suaj. Ju merrni ndihmë sociale vetëm kur të gjitha ndihmat dhe mbështetjet e tjera nuk janë të disponueshme ose nuk mjaftojnë. Qëllimi i ndihmës sociale është që ju së shpejti të jeni në gjendje të kujdeseni përsëri për veten tuaj. Ndihma sociale nuk është sigurim, por një mbështetje nga shteti. Në kantonin e Schaffhausen-it janë përgjegjëse kantoni dhe komunat së bashku për përcaktimin e ndihmës sociale. Me pyetje në rast të veçantë drejtohuni në komunat tuaja të banimit.

TAKSAT



22

DETYRIMI TATIMOR

Në Zvicër, kostot për pagesat publike si infrastruktura, qarkullimi, arsimi, policia dhe ushtria, shëndetësia, siguria sociale etj. paguhen kryesisht nga taksat e personave privatë dhe ndërmarrjeve si dhe nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Me anë të kësaj kontribuojnë të gjithë për një jetë publike mirë funksionuese.

SI MBLIDHEN TAKSAT?

Për llogaritjen e taksave mbi të ardhurat dhe pasurinë që duhet të paguhen duhet që zvicëranet dhe zvicëranët si dhe persona me një lejë qëndrimi të përhershme „C“ të mbushin çdo vit një deklaratë tatimore. Formularët për deklaratën tatimore ju dorëzohen juve përkatësisht në fillim të vitit. Deklarata tatimore mund të plotësohet me një softuer për taksat pa pagesë dhe të paraqitet në formë elektronike (eFiling) ose nëpërmjet postës. Punëmarrësve të huaj me vendbanimin tatimor ose qëndrimin në Zvicër, të cilët nuk kanë as lejen e përhershme të qëndrimit „C“, as nuk janë të martuar me një person, i cili posedon të drejtën e qytetarit zvicëran ose lejen e përhershme të qëndrimit (C), iu hiqen taksat direkt nga rroga (tatimi në burim). Kjo prek personat me një leje qëndrimi vjetore „B“, azilkërkues si dhe të huaj me qëndrim javor dhe të huaja me qëndrim javor. Një person me detyrim të pagimit të tatimit në burim duhet, megjithatë, të plotësojë një deklaratë tatimore, nëse ai i nënshtrohet vlerësimit të mëvonshëm të rregullt (p.sh. në rast të të ardhurave nga puna prej të paktën 120'000 CHF).

Në rast të pyetjeve drejtohuni në administratën e financës së komunës suaj, në një vend këshillimi ose në një administratore e besuar, një administrator i besuar.

- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Administrata tatimore: Informacione të shumta për pyetje në lidhje me taksat, llogaritës taksash në linjë (online), shkarkim softueri taksash.*
- ▶ *Nxijtja e ekonomisë e Schaffhausen-it – Tax Guide: Libri i dorës ju ndërmjetëson juve në formë kompakte dhe qartë të dhënat për sektorin fiskal në kantonin e Schaffhausens-it.*

MARTESA DHE PARTNERITETI



MARTESA

Për tu mundur të lidhet një martesë, në Zvicër duhet të jetë mbushur moshë 18 vjeç. Këtu njihen vetëm martesat, të cilat janë lidhur pranë një zyre të gjendjes civile. Në kantonin e Schaffhausen-it është përgjegjëse zyra e gjendjes civile e qytetit të Schaffhausen-it për të gjitha fushat rreth lidhjes së martesës, njohjes së lindjeve dhe rasteve të vdekjes. Ajo ju informon për kushtet paraprake që duhet të mbushen për lidhjen e martesës dhe dokumentet e nevojshme për këtë. Në Zvicër mund të martohen edhe persona të gjinisë së njëjtë.

PARTNERITETI

Në Zvicër janë të mundshme dhe pranohen forma të ndryshme të bashkëjetesës. Shumë çifte jetojnë të pamtuar së bashku (bashkëjetesë jashtë martesë) dhe kanë fëmijë të përbashkët. Për këta çifte ekziston mundësia, të lidhin një kontratë bashkëjetesë jashtë martesë. Kjo mund të vërtetohet tek një noter dhe të rregullojë, për shembull, kujdestarinë dhe pensionin ushqimor për fëmijët, çfarë i takon kujt ose si ndahen kostot e ekonomisë shtëpiake.

NDARJA

Shkurorëzimi mund të kërkohet bashkërisht nga të dy bashkëshortët dhe bashkëshortet ose vetëm nga njëri bashkëshort ose njëra bashkëshorte. Kompetente është gjykata familjare e rrethit. Edhe martesat, të cilat janë lidhur jashtë vendit, gjithashtu mund të shkurorëzohen sipas ligjit zviceran. Për këtë, qendra e jetesës duhet të jetë në Zvicër dhe duhet jetuar këtu për të paktën një vit. Nëse persona të huajt mund të mbajnë pas divorcit pretendimin e tyre për qëndrimin, varet nga faktorë të ndryshëm. Për informacion rreth divorcit mund të drejtohet tek një vend për këshillim martesor dhe familjar ose një vend këshillimi ligjor.

- ▶ *Qyteti i Schaffhausen-it – Zyra e gjendjes civile: Informacione për parapërgatitjen e martesës.*
- ▶ *binational.ch: Informacione për çifte binacionale dhe familje ndërkulturore*
- ▶ *Vend këshillimi për partneritet dhe shtatzëni Schaffhausen (Beratungsstelle für Partnerschaft und Schwangerschaft Schaffhausen): Këshillime për çifte dhe për jetën si dhe këshillime mbi shtatzëninë, lindjen, parandalimin e shtatzënisë.*
- ▶ *Pink Cross: Organizata zvicerane e homoseksualëve, ofertë e gjerë këshillimi.*
- ▶ *LOS: Organizata zvicerane e lesbikeve.*
- ▶ *Transgender Network Switzerland: Informacione dhe këshillim rreth temës transgjini.*
- ▶ *InterAction: informacione dhe këshillim rreth temës së ndërgjinisë / njerëzve ndërgjinorë.*

MARTESA DHE PARTNERITETI



24

E DREJTA E ZGJEDHJES SË LIRË TË PARTNERIT - MARTESA ME DETYRIM DHE KURORË E DETYRUAR

Në Zvicër vlen e drejta e zgjedhjes së lirë të partnerit respektivisht të partneres. Familjet ose persona të tjerë sipas kësaj nuk kanë të drejtë të detyrojnë gratë ose burrat të martohen kundër dëshirës së tyre. Një detyrim dëmton të drejtat themelore të njeriut si dhe të kushtetutës zvicerane dhe është i dënueshëm. Një martesë, e cila është lidhur nën detyrim, përveç kësaj mund të shpallet e pavlefshme nga autoritetet, pavarësisht nga kjo, nëse është lidhur brenda apo jashtë vendit.

DHUNA SHTËPIAKE

Dhuna shtëpiake nuk lejohet në Zvicër dhe ndiqet penalisht. Me dhunë shtëpiake nënkuptohet dhuna fizike, psikologjike ose seksuale brenda një familjeje ose një marrëdhënieje partneriteti aktuale ose që është në prishje e sipër. Viktimat e dhunës shtëpiake marrin mbështetje dhe këshilla – nga përballja psikologjike me përvojën e dhunës deri te sqarimi i çështjeve ligjore dhe deri te ndërmjetësimi i strehimeve emergjente. Personat që ushtrojnë dhunë dhe që janë të gatshëm të ushtrojnë dhunë mbështeten në zhvillimin e opsioneve të reja për veprim për t'i dhënë fund dhunës ose për të mos e përdorur fare atë.

- ▶ *Vendi i specializuar për të prekur nga dhuna në Schaffhausen (Fachstelle für Gewaltbetroffene Schaffhausen FSGB): Këshilla viktimash anonime dhe pa pagesë për gra, burra, fëmijë dhe të rinj, ndër të tjera në rast të martesës me detyrim, kurorës së detyruar dhe dhunës shtëpiake.*
- ▶ *Vendi i specializuar për ushtrues dhune, Schaffhausen, Konflikt. Gewalt: Këshillime anonime dhe pa pagesë për persona që ushtrojnë dhunë dhe që janë të gatshëm të ushtrojnë dhunë.*
- ▶ *Vendi i specializuar për martesën me detyrim (Fachstelle Zwangsheirat) Zvicër: Këshillon dhe shoqëron njerëz të prekur nga martesë me detyrim dhe kurora e detyruar ose mjedisin e tyre.*

FAMILJA DHE FËMIJËT



PLANIFIKIMI FAMILJAR DHE LINDJA

Lindja e një fëmije sjell me vete shumë ndryshime. Në regjionin e Schaffhausen-it ka oferta të ndryshme, të cilat ju përgatisin juve për këtë hap dhe ju shoqërojnë pas lindjes. Çdo lindje duhet t'i njoftohet zyrës së gjendjes civile të qytetit të Schaffhausen-it. Lindet fëmija në një spital, kështu e njofton spitali lindjen. Gjatë një lindjeje në shtëpi është mamia e detyruar ta njoftojë fëmijën. Mamia shoqëron në mënyrë profesionale gratë shtatzëna, ato që lindin dhe lehonat dhe ofron kujdes të vazhdueshëm që nga shtatzënia deri në lindje dhe deri në fund të lehonisë.

- ▶ *Qyteti i Schaffhausen-it – Zyra e gjendjes civile: Fletëshpjegim dhe dokumentet e nevojshme përreth regjistrimit të ditëlindjes.*
- ▶ *Vend këshillimi për partneritet dhe shtazëni (Beratungsstelle für Partnerschaft und Schwangerschaft): Këshillime për çifte dhe për jetën si dhe këshillime mbi shtazëninë, lindjen, parandalimin e shtazënisë.*
- ▶ *Spitale në Schaffhausen: Ofrojnë, ndër të tjera, parapërgatitje lindjeje për gra dhe çifte.*
- ▶ *Shoqata zvicerane e mamive: Platformë interneti e mamive me profesion të lirë të regjionit të Schaffhausen-it.*
- ▶ *Fletëpalosje «Für uns da» (Për ne këtu) Kantoni Schaffhausen: Pamje e pikave të këshillimit për prindër me bebe dhe fëmijë të vegjël. Fletëpalosja është e përkthyer në shumë gjuhë.*

TË JESH PRIND

Të edukosh fëmijë është një detyrë me kërkesa të larta. Në jetën e përditshme, prindërit e pyesin veten në mënyrë të përsëritur se çfarë është më e mira për fëmijën e tyre. Të jetosh në një mjedis të ri sjell sfida shtesë për familjet. Keni nevojë për njohuri shtesë orientuese. Shkëmbimi me prindërit e tjerë gjatë kësaj është shumë i vlefshëm.

Ekziston një gamë e gjerë ofertash për nëna dhe baballarë që duan të shkëmbejnë ide me prindër të tjerë ose të marrin pjesë në aktivitete me fëmijën e tyre. Disa oferta janë orientuar posaçërisht në atë, që prindër zviceranë dhe të huaj të mund të lidhin kontakt. Ka edhe qendra të specializuara këshillimi që ndihmojnë prindërit në pyetjet rreth edukimit, zhvillimit dhe shëndetit të fëmijëve të tyre.

- ▶ *wegweiser.sh – platforma e informacionit Schaffhausen për fëmijë, të rinj dhe familje: Në platformën online ju gjeni qendra këshillimi, oferta të kohës së lirë dhe të kujdestarisë, kurse, kurse të formimit prindëror dhe më shumë.*

EDUKIMI, SHËNDETI DHE ZHVILLIMI

Në Zvicër janë mbuluar nëpërmjet sigurimit bazë në katër vitet e para të jetës tetë kontrolle përkujdesjeje të mjekut të fëmijëve për zhvillimin e fëmijës. Në të njëjtën kohë iu qëndron në krah prindërve me këshilla dhe vepra këshillimi për nëna dhe baballarë. Në rast të pyetjeve për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve tuaj ose në rast të problemeve në shkollë, ju mund të drejtoheni në vende të ndryshme këshillimi, të cilat kërkojnë me ju zgjidhje të përbashkëta.

- ▶ *doktor.ch: Klinika mjekësore për fëmijë në kantonin e Schaffhausen-it*
- ▶ *Spitex Schaffhausen – Këshillimin për nëna dhe baballarë: Këshillon në rast të pyetjeve për shëndetin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijës suaj (0-5 vjeç).*
- ▶ *Vendi i specializuar për pedagogji kurimi dhe logopedi në fazat e hershme (Fachstelle für Heilpädagogik und Logopädie im Frühbereich) Schaffhausen: Sqarim, këshillim dhe terapi për fëmijë me spikatje në zhvillim ose të meta që nga lindja deri në hyrjen në kopshtin e fëmijëve.*
- ▶ *Spitäler Schaffhausen – Shërbim psikiatrik për fëmijë dhe të rinj (Kinder- und Jugendpsychiatrischer Dienst KJPD): Vendi i specializuar për zhvillimin psikik të fëmijëve dhe të rinjve dhe të familjeve të tyre. „KJPD“-ja kryen krahas sqarimit dhe terapisë edhe këshilla për prindër dhe persona të specializuar.*

FAMILJA DHE FËMIJËT



26

- ▶ *Vendi i specializuar Teddybär: Këshillimorja psikologjike në Schaffhausen për prindër dhe fëmijë rreth temës edukimi dhe zhvillimi i fëmijës.*
- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Sqarim dhe këshillim shkollor (Schulische Abklärung und Beratung SAB): Këshillimi i personave mësimdhënës dhe prindërve në rast të fëmijëve me probleme në të mësuar dhe në rezultate, talente të veçanta, vështirësi motivimi dhe marrëdhëniesh ose me rënie në sy në sjelljen sociale në kopshte të fëmijëve dhe shkolla.*
- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Shërbimi për fëmijët dhe të rinjtë (Kinder- und Jugenddienst KJD): Këshillim dhe mbështetje, nëse zhvillimi i fëmijëve dhe të rinjve duket i rrezikuar.*
- ▶ *Këshillime për të rinj Schaffhausen: Këshillim dhe shoqërim në rast të problemeve në familje, në shkollë ose në vendin e punës. Oferta drejtohet ndaj të rinjve në moshën ndërmjet 12-24 vjet si dhe ndaj familjeve të tyre, prindërve, personave mësimdhënës dhe mësuesëve dhe mësuesëve profesional.*
- ▶ *Pro Junior Schaffhausen/Thurgau: Organizon aktivitete dhe ofron mbështetje materiale për familje dhe fëmijë.*
- ▶ *Informacione për prindërit: - Letra për prindërit Pro Juventute: Informacione praktike për ushqimin, shërbimin, zhvillimin dhe edukimin. Të përkthyer në shumë gjuhë. Marrja nëpërmjet Këshillimit për nënat dhe baballarët ose komunës suaj. - Parentu: Aplikacioni informon prindërit në 15 gjuhë mbi zhvillimin e fëmijës nga lindja deri në ditëlindjen e 16-të.*

KUJDESTARIA DHE FORMIMI JASHTË FAMILJES

Në kantonin e Schaffhausen-it qëndrojnë në dispozicion për familjet oferta të ndryshme plotësuese dhe mbështetëse familjare.

Ato arrijnë nga vende këshillimi, mbi shërbime të kujdesit për fëmijët, grupe të zvarritjes ose lojës e deri në kopshte ditore fëmijësh dhe strehë ditore. Shfrytëzoni ofertat! Ato u ofrojnë fëmijëve tuaj mundësinë për të krijuar kontakte fillestare me fëmijë të tjerë dhe ju japin një mundësi të mirë për të njohur familje të tjera.

- ▶ *Qendra për familjen Schaffhausen Qendra familjare pranë sheshit Kirchhofplatz është një vend ku nëna, baballarë, gjyshër dhe kujdestarë të tjerë me fëmijë të vegjël mund të takohen dhe të krijojnë kontakte. Ndër të tjera ka një bistro me një zonë lojërash, një pikë mbështetje për nëna dhe baballarë, një qendër informacioni dhe dhoma që mund të përdoren për kurse dhe evenimente.*
- ▶ *Qyteti i Schaffhausen-it – Fëmijëria e hershme: Vendi i specializuar Nxitja e hershme është i përkushtuar për arsimimin, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të vegjël deri në hyrjen në kopsht. Vendi i specializuar është i përkushtuar për kushte të përgjithshme të mira dhe një cilësi të lartë të institucioneve të kujdesit. Ai informon, koordinon dhe ndërlihd njerëz dhe organizata të nxitjes së hershme në zonën e qytetit.*
- ▶ *Komuna e Neuhausen-it – Fëmijëria e hershme: Vendi i specializuar Fëmijëri e hershme nxit familjet me fëmijë deri në gjashtë vjeç me këshillim dhe mbështet oferta në komunën. Ai organizon rregullisht aktivitete për familje si dhe një kafene javore prindër-fëmijë.*
- ▶ *Zhvillimi i lagjeve në Schaffhausen: Zhvillimi i lagjeve të qytetit të Schaffhausen-it administron qendrën e familjes dhe disa takime të lagjes.*
- ▶ *Komisioni i Fëmijëve dhe Rinisë Thayngen – thayngen4kids: Informacion mbi ofertat për fëmijë, të rinj dhe familje në Thayngen dhe zonën përreth.*

Kujdestari plotësuese familjare dhe oferta të tjera

Për kujdestarinë e fëmijëve tuaj ju qëndrojnë në dispozicion në Schaffhausen kopshte ditore fëmijësh (KiTa), familje ditore, strehë ditore shkollore ose edhe tryeza dreke. Sipas nevojës kujdeset atje për fëmijët për gjithë ditën ose me orë. Të gjitha ofertat janë me pagesë. Në disa komuna institucionet subvencionohen. Komuna juaj ju informon juve mbi ofertat në rrethinat e afërta dhe jep informacione mbi pjesëmarrjen në kosto.



- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Vendi i shërbimit Sport, Familje dhe Rini: Përveç mbikëqyrjes së përkujdesjes për familje dhe plotësuese shkollore, vendi mban një vështrim të ofertave të institucioneve të përkujdesjes në kanton.*
- ▶ *Qyteti i Schaffhausen-it – Përkujdesja për fëmijë dhe të rinj: Platforma e informacioneve e qytetit të Schaffhausen-it për kopshtet ditore të fëmijëve, strehët ditore shkollore, tryezat e drekës dhe oferta të tjera për përkujdesjen e fëmijëve.*
- ▶ *Zweidihei – Shoqata për kujdesin e fëmijëve: Kujdesi në familjet ditore.*
- ▶ *Kryqi i Kuq Schaffhausen: Oferta lehtësimi për familjen, ndërmjetësim i kujdestareve për fëmijë.*

Grupet e lojës

Në grupet e lojës fëmijët, para hyrjes në kopshtin e fëmijëve, nxiten duke luajtur në kompetencat e tyre gjuhësore dhe sociale. Grupi i lojës zhvillohet si rregull dy herë në javë për 2 deri 4 orë. Orientimi i grupeve të lojës të Schaffhausen-it është i shumanshëm, kështu ka për shembull grupe, të cilët takohen në pyll ose në oborrin e fermës ose të tilla, të cilat e vendosin një fokus special mbi nxitjen e gjuhës.

- ▶ *Vendi i specializuar dhe i kontaktit për grupet e lojës në Schaffhausen (Fach- und Kontaktstelle Spielgruppen Schaffhausen): Lista e grupeve të lojës si dhe informacione të përgjithshme për grupet e lojës.*

MuKi- / VaKi- / ElKi-Turnen

(gjimnastikë nënë-fëmijë / babë-fëmijë / prindër-fëmijë)
Gjimnastika nënë-fëmijë / babë-fëmijë / prindër-fëmijë iu drejtohet prindërve me fëmijët e vegjël në moshën 3-5 vjet. Në orët e përbashkëta të gjimnastikës nxiten në formë loje shëndeti dhe lëvizshmëria.

MËSIMI I GJUHËS

Shumë prindër janë të pasigurt, cilën gjuhë duhet t'i ndërmjetësojnë ata fëmijëve të tyre në mjedisin e ri. Njo-huritë e sotme dëshmojnë që prindërit duhet të flasin me fëmijët e tyre gjuhën e parë të tyre (gjuhën e nënës) dhe

ta nxitin atë. Në të njëjtën kohë prindërit mund t'i mbështetin fëmijët gjatë mësimit të gjuhës së mjedisit. Kjo do të thotë në linjë të parë, që ju t'ua mundësoni fëmijëve tuaj kontaktin me fëmijë të tjerë dhe, për shembull, t'i regjistroni ata në një grup loje ose në një kopsht ditore fëmijësh.

- ▶ *Integres, vendi i specializuar për integrimin i regionit të Schaffhausen-it: Vend këshillimi për migrante dhe migrantë në rast çështjesh për jetën e përditshme. Ndërmjetësimi i ofertave për nxitjen gjuhësore.*
- ▶ *migesplus.ch – Portal për barazinë e shanseve shëndetësore: Fol me mua dhe më dëgjo me vëmendje: Këshillues për prindër me sugjerime, si mund të mbështeten fëmijët gjatë mësimit të gjuhës. Fletorja përmban këshilla praktike, se si fëmijët mund të rriten mirë me dy ose edhe me më shumë gjuhë. E përkthyer në shumë gjuhë.*
- ▶ *Instituti Zviceran për Mediat e Fëmijëve dhe Rinisë (Schweizerisches Institut für Kinder- und Jugendmedien SIKJM) – Promovimi i leximit në familje: Këshillues për prindër, si fëmijët mund të mbështeten gjatë promovimit të të folurit dhe të leximit. E përkthyer në shumë gjuhë.*

OFERTA PËR TË RINJ

Kantoni i Schaffhausen-it angazhohet për çështjet e të rinjve. Vendi i specializuar për nxitjen e fëmijëve dhe të rinjve ndërlidh komunitetet dhe shoqatat e punës rinore. Ai i mbështet ata me informacione dhe këshilla. Qyteti i Schaffhausen-it dhe komunitete të tjera mbështesin të rinjtë me punë rinore.

- ▶ *Qyteti i Schaffhausen-it – Puna me të rinjtë: Puna me të rinjtë qarkullon rregullisht në hapësirën publike të qytetit dhe në këtë mënyrë ofron mundësi me pengesa të ulëta për kontakt. Ofertat, programet dhe projektet e punës me të rinjtë i dedikohen aktiviteteve të suksesshme të kohës së lirë dhe zhvillimit personal.*
- ▶ *Shoqata për çështjet e të rinjve, parandalim dhe ndihmë ndaj varësisë (Verein für Jugendfragen, Prävention und Suchthilfe VJPS): Vendi i specializuar për nxitjen e shëndetit, parandalimin dhe këshillimin ndaj varësisë në Schaffhausen.*
- ▶ *Parlamenti i rinisë i Schaffhausen-it: Platformë për pjesëmarrjen politike të të rinjve.*

SHKOLLA



28

SISTEMI I ARSIMIT NË KANTONIN E SCHAFFHAUSEN-IT

Në kantonin e Schaffhausen-it fëmijët vijnë fillimisht shkollën primare (dy vite kopsht të fëmijëve, gjashtë vite shkollë primare) dhe pastaj shkollën sekondare (shkollë reale ose shkollë sekondare).

Mësimi deri në dhe me shkollën sekondare II është falas. Materiali shkollor është që nga shkalla sekondare II me detyrim pagese.

KOHA E DETYRUESHME E SHKOLLËS

Që nga përfundimi i vitit të 4-t të jetës fillon më së herëti kopshti i fëmijëve. Në kopshtin e fëmijëve i vihet vlerë në veçanti të mësuarit në formë loje, kontaktit social dhe mësimi të gjuhës. Shkolla primare fillon që nga viti i 6-të i jetës. Koha e shkollës primare zgjat si rregull gjashtë vjet. Pas kësaj pason kalimi në shkollën reale dhe sekondare (shkalla sekondare I). Fëmijë me një aftësi të kufizuar vizitojnë ose një shkollë të veçantë, ose integrohen në një klasë të rregullt.

BASHKËPUNIMI NDËRMJET SHKOLLËS DHE PRINDËRVE

Prindërit janë përgjegjës kryesorë për edukimin dhe formimin e plotë të fëmijëve të tyre. Ata janë të detyruar, t'i futin fëmijët në shkollë dhe të kujdesen për këtë, që ata të zbatojnë vajtjen në shkollë, planin e orëve dhe rregullin e shkollës. Po ashtu ata duhet të sigurojnë, që fëmijët të kryejnë detyrat e tyre të shtëpisë dhe që atyre t'iu qendrojnë në dispozicion kushtet e përgjithshme të nevojshme për to.

Bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe prindërve ka një domethënie qendrore në Zvicër. Prindërit ftohen nga shkolla rregullisht për biseda me prindërit dhe mbërmeje me prindërit. Pjesëmarrja juaj është e rëndësishme, me qëllim që ju t'i shoqëroni mirë fëmijët tuaj gjatë kohës së shkollës dhe në rast të problemeve në shkollë ose për zgjedhjen e pritur të profesionit të mund të gjenden zgjidhje të përbashkëta.

► *Kantoni i Schaffhausen-it – Departamenti i edukimit: Informacione për temat e shkollës. Për pyetje konkrete për shkollën e fëmijëve tuaj, drejtoheni direkt në komunën tuaj të banimit.*

SHKOLLA E DETYRUESHME POPULLORE

Shkalla paraprake	Shkalla primare	Shkalla sekondare I	Shkalla sekondare II	Shkalla terciare
Kopshti i fëmijëve	Shkolla primare	Shkolla sekondare Shkolla reale	Shkolla e mesme (Shkolla e kantonit) Shkolla e mesme profesionale Mësim profesioni Matura profesionale	Universiteti ETH Shkolla e lartë e specializuar Shkolla e specializuar më e lartë
2 vjet	6 vjet	2 – 3 vjet	2 – 4 vjet	2 – 6 vjet



GJERMANISHTJA SI GJUHË E DYTË (DAZ) DHE KLASË HYRJEJE PËR ATA QË FLASIN GJUHË TË HUAJA (EFF)

Nëse fëmija juaj hyn në shkollë me asnjë ose me pak njohuri të gjuhës gjermane, shkolla ofron forma të ndryshme të mbështetjes. Masa e përshtatshme merret nga personi mësimdhënës dhe nga përgjegjësit për „DAZ“-in. Në linjë të parë integrohen fëmijët në klasën e rregullt dhe marrin si shtesë mësim gjermanisht. Komuna të veçanta disponojnë klasa hyrjeje për ata që flasin gjuhë e huaja (EfF).

- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Schulportal: Gjermanisht si gjuhë e dytë: Informacione për nxitjen e parë dhe të mëtejshme për fëmijë me gjuhë të huaj në shkollën e rregullt.*

MËSIM NË GJUHËN DHE KULTURËN E VENDLINDJES (HSK)

Njohuri të mira në gjuhën e parë i mbështetin nxënëset dhe nxënësit me gjuhë të huaj gjatë mësimin të gjuhëve të tjera. Konsullata të ndryshme dhe mbartës privatë ofrojnë prandaj, për fëmijë dhe të rinj me gjuhë të huaj, kurse në gjuhën dhe kulturën e vendlindjes. Kurset më të shumta fillojnë në klasën e 2-të. Mbartës individualë ofrojnë kurse gjithashtu në një moment më të hershëm në kohë. Regjistrimi, si rregull, bëhet përmes shkollës publike. Nota e „HSK“-së mund të shënohet në formë semestri në dëftesën e shkollës.

- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Portali shkollor: Gjuha dhe kultura e vendlindjes: Informacion për mësimin „HSK“ dhe kurse aktuale.*

SHKOLLAT PRIVATE

Në Schaffhausen ofrojnë disa shkolla private mësim në sisteme alternative shkollash: International School of Schaffhausen ISSH jep mësim sipas planit mësimor të International Baccalaureate Organization (IBO)“; gjuha e mësimin është anglisht. Waldorfschule ofron mësim sipas pedagogjikës Waldorf. Shkolla „Stadtrandschule“ (shkolla e anës së qytetit) është një shkollë për gjithë ditën për vitin e 1-9 shkollor. Shoqata Waldläufer [Vrapuesit e pyllit] drejton një shkollë bazë (kopshti i 1-rë deri në dhe përfshirë klasën e 2-të) në Neuhauser Wald. Në Hallau ka një shkollë tandem për klasën e 1-rë deri të 6-të.

- ▶ *International School of Schaffhausen: Të gjitha shkollët nga moshë 3 vjeç deri në Diploma Years Curriculum. [Kurrikulën e viteve të diplomës].*
- ▶ *Waldorfschule Schaffhausen dhe kopshti i fëmijëve: Klasa e 1-rë deri e 5-të, kopsht fëmijësh, grup lojërash dhe grup prindër-fëmijë.*
- ▶ *Stadtrandschule (shkolla e anës së qytetit) në Schaffhausen: Shkollë për gjithë ditën për vitin shkollor 1-9.*
- ▶ *Qendra e natyrës dhe arsimit Waldläufer: Shoqata është e përkushtuar ndaj ofertave të edukimit për natyrën në kantonin e Schaffhausen.*
- ▶ *Tandemschule: Shkollë e vogël private e krishterë në Hallau.*

FORMIMI PROFESIONAL DHE STUDIMI



30

SHKOLLAT E MËTEJSHME DHE FORMIMI PROFESIONAL – SHKALLA SEKONDARE II

Të rinjtë, pas kohës së detyrueshme të shkollës, mund të kryejnë një shkollë të mëtejshme ose një mësim profesional. Përfundimi i profesionit formon një pjesë thelbësore të sistemit arsimor zviceran.

Formimi bazë profesional i shërben përfitimit të aftësive dhe njohurive, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin e një profesioni. Zvicra njihë sistemin e formimit profesional të ashtuquajtur «dual». Në këtë kuptohet formimi profesional paralel në ndërmarrje dhe në shkollën profesionale. Rreth 70% e të gjithë të rinjë e nisin karrierën e profesionit në këtë rrugë. Kusht paraprak për një mësim profesional është një kontratë për mësim profesional me një ndërmarrje.

Dallohen dy formime bazë profesionale:

1. Dëshmia e aftësisë: Formimi tre-katër vjeçar bazë përfundohet si rregull me një provim për mësimin e profesionit dhe çon në një dëshmi konfederative aftësisë. Dëshmia konfederative e aftësive çon së bashku me përfundimin e një formimi të zgjeruar të përgjithshëm në një pjekuri profesionale.

2. Certifikata e profesionit: Formimi dyvjeçar bazë përfundohet si rregull me një provim dhe çon në një certifikatë konfederative profesioni. Ajo është e krijuar në këtë mënyrë, që ofertat t'iu përshtaten veçanërisht nxënësve profesionale të talentuar praktikisht.

Duke u shoqëruar me mësimin [e profesionit] ose pas përfundimit të tij mund të kryhet edhe matura profesionale. Matura profesionale mundëson hyrjen për në shkollat e larta të specializuara.

Vizita e **shkollës së kantonit (gjimnazit)** me përfundimin e maturës është kushti paraprak kryesor për lejimin në shkollat e larta.

Shkolla e mesme profesionale ofron pas tre vitesh formimi të përgjithshëm dhe një vit praktikë, përfundimin e pjekurisë profesionale, i cili jep të drejtën e marrjes së një studimi në një shkollë të lartë teknike.

Shkolla e Mesme Tregtare çon në një diplomë si tregtar/tregtare EFZ [dëshmi konfederative aftësisë] në kombinim me një maturë profesionale tregtare.

- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Vendi i shërbimit Formim profesional dhe këshillim profesional: Informacione dhe këshilla për formimin e plotë dhe të mëtejshëm profesional, dhënie ndihme në rast të pyetjeve për ndërmarrjet ku mësohet dhe të marrëdhënieve gjatë të mësuarit.*
- ▶ *Shkolla e kantonit Schaffhausen: Shkolla e kantonit në Schaffhausen ofron mundësinë, të jepet një formim dygjuhësor (gjermanisht-anglisht / gjermanisht - frëngjisht).*

STUDIMI - SHKALLA TERCIARE

Zvicra ka një ofertë të pasur për mundësi studimi. Formimi i lartë profesional pas mësimit të profesionit ose pas gjimnazit është me detyrim pagese (universiteti, shkolla e lartë konfederative teknike, shkolla e lartë pedagogjike, shkolla e lartë e specializuar, shkolla më e lartë e specializuar).

- ▶ *Berufsberatung.ch: Të gjitha të dhënat për studimin.*
- ▶ *Perspektiven-Studium: Platformë me informacione dhe projekte për hyrjen në shkollën e lartë për refugjatët.*



INFORMACIONE DHE KËSHILLA PËR ZGJEDHJEN E PROFESIONIT DHE FORMIMIN E MËTEJSHËM

Qendra e informacionit për profesionin (BIZ) i qëndron hapur popullsisë së Schaffhausen-it për informacione dhe këshillime përreth zgjedhjes së profesionit, zgjedhjes së studimit, karrierës tjetër profesionale dhe mundësive të formimit të mëtejshëm. Në faqen e internetit dhe në „BIZ“ në rrugën „Herrenacker 9“ mund të shihen portrete të shumta profesioni. Secili mund të lerë të këshillohet në vend pa lajmërim. Në rast të pyetjeve që çojnë më tej do të vendoset një terminë këshillimi. Në një konsultim, klientet dhe klientët njohin më mirë interesat dhe aftësitë e tyre dhe zhvillojnë ide për mundësi profesionale. Për të rinj deri në 20 vjet, të cilët banojnë në kantonin Schaffhausen, këshillimet janë parimisht falas. Të rriturve ju qëndron hapur këshillimi për karrierën. Për persona, të cilët banojnë në kantonin e Schaffhausen-it, janë të tre këshillimet e para nga 1 orë falas. Këshillimet e tjera janë me detyrim pagese.

- ▶ *Qendra e informacionit për profesionin e kantonit të Schaffhausen-it (Berufsinformationszentrum BIZ): Këshillime për profesionin, studimin dhe karrierën. Informacione dhe këshillim në të gjitha pyetjet përreth kualifikimit shkollor dhe profesional.*

OFERTA URA

Kush pas kohës së detyrueshme të shkollës, nuk e gjen dot rrugën direkte për në një formim profesional bazë ose në një shkollë të mëtejshme, mund të vizitohet një ofertë urë. Qendra e informacionit për profesionin (BIZ) ju këshillon juve në rast të zgjedhjes së një oferte të drejtë. Qendra për formimin profesional (BBZ) Schaffhausen ofron në vitin e parapërgatitjes për profesion modele të ndryshme. Për të rinjtë dhe të rriturit e emigruar vonë, të cilët nuk kanë ndjekur shkollën e detyrueshme në Zvicër, ose e kanë ndjekur vetëm për një kohë të shkurtër, në kantonin e Schaffhausen-it ekziston një program arsimor me dy faza. Faza e parë zhvillohet në programin arsimor bazë JUMA të SAH Schaffhausen me qëllim kalimin në kurset e integritit të orientuar drejt formimit profesional të BBZ. Kurset e integritit zhvillohen si model me kohë të plotë ose në kuadër të një paramësimi integrues si model shoqërues pune me pjesë shkollore dhe praktike. Synimi i kësaj oferte është, të mundësohet hyrja në formimin profesional bazë në Zvicër.

- ▶ *Qendra e formimit profesional e kantonit të Schaffhausen-it (Berufsbildungszentrum BBZ): Informacione për ofertat e ndryshme të vitit të parapërgatitjes për profesion, në veçanti për kursin e integritit të „BBZ“-së për të rinj të huaj.*
- ▶ *Organizata bamirëse zvicerane e punëtorëve (Schweizerischen Arbeiterhilfswerks SAH): Kursi „JUMA-B“ për të rinjtë nga 16 - 25 vjeç si dhe oferta të shumta formimi dhe mbështetjeje për integrimin social dhe profesional.*
- ▶ *Paramësimi integrues INVOL: Paramësimi drejtohet ndaj refugjatëve të njohur, personave të pranuar paraprakisht, personave të ardhur vonë nga BE/EFTA dhe vendet e treta, si dhe personat me status mbrojtjeje S, të cilët janë të motivuar të përfundojnë një formim profesional në Zvicër.*
- ▶ *START! Studium: Kursi paraprak i integritit në Universitetin e Cyrihut është një ofertë dy-semestrare për refugjatët me potencial për një studim në një shkollë të lartë. Në program pjesëmarrësit përgatiten në aspektin gjuhësor, profesional dhe organizativ për kërkesat e studimeve në Zvicër.*



32

KUJDESI MJEKËSOR

Personat më të shumtë në Zvicër kanë një mjekë shtëpie ose një mjek shtëpie, e cila/i cili është personi i parë të cilit i drejtoheni në rast të pyetjeve për shëndetin tuaj. Schaffhausen-i disponon dy spitale: spitalin publik të kantonit dhe klinikën private „Belair“. Dërgimi në spital pason zakonisht nëpërmjet mjekes së shtëpisë / mjekut të shtëpisë. Jashtë kohës së orareve të konsultave mund të shkohet në raste emergjente edhe në klinikën emergjente ose në stacionin emergjent të spitalit të kantonit.

- ▶ Shoqata kantonale e mjekëve në Schaffhausen: Ndër të tjera, kontakte me mjeket dhe mjekët me veprimtari në Schaffhausen.
- ▶ Shoqata e mjekëve të shtëpisë (Hausarztverein) në Schaffhausen: Kontakte tek mjeket e shtëpisë dhe mjekët e shtëpisë me veprimtari në regjion.
- ▶ Spitäler Schaffhausen: Në këtë faqe ju gjeni informacione për spitalin e kantonit (përfshirë rehabilitimin dhe kujdesin e përkohshëm), për qendrën e psikiatrisë Breitenau si dhe psikiatrinë për fëmijë dhe për të rinj.
- ▶ Klinika private Belair në Schaffhausen: Klinika private në lagjen e banimit Breite.

RASTE EMERGJENTE MJEKËSORE

Në kantonin e Schaffhausen-it sigurohet shërbimi emergjent ambulant nëpërmjet mjekëve dhe mjekëve në klinikat e pavarura. Gjatë orarit normal të hapjes së klinikave drejtoheni, edhe në rast emergjence, tek mjekja juaj e shtëpisë ose mjeku juaj i shtëpisë. Në rast të mungesës së tyre mësoni emrin dhe numrin e telefonit të klinikës që ka shërbim. Jashtë orareve të hapjes ju mund t'i drejtoheni klinikës së emergjencës së Schaffhausen-it, e cila ndodhet në pranimin emergjent në spitalin e kantonit të Schaffhausen-it. Ajo drejtohet nga mjekë familjarë dhe mjekë familjarë në rajon në mbrëmje dhe gjatë gjithë ditës në fundjavë. Klinika emergjente në spitalin kantonial është i hapur 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.

▶ Çfarë bëhet në emergjencë:

Përmes numrit të telefonit 052 634 34 00 ju do të drejtoheni përmes vendit udhëheqës në kujdesin e përshtatshëm të urgjencës: Kjo mund të jetë klinika shërbyese e mjekut të familjes gjatë ditës, Klinika e rasteve emergjente ose stacioni i rasteve emergjente. Në raste urgjente me rrezik për jetën telefononi në numrin 144.

- ▶ Vendi i sqarimit dhe i ndërhyrjes në rast krizash (Abklärungs- und Kriseninterventionsstelle KiSH) Vendi i sqarimit dhe i ndërhyrjes në rast krizash (KiSH) është një ofertë e Shërbimit Psikiatrik dhe ndodhet në Qendrën Psikiatrike në Breitenau. Ai mundëson takime profesionale ambulatorë afatshkurtra (brenda 24 deri në maksimum 48 orë) për t'ju mbështetur në përballimin e situatave të krizës. Tel. 052 634 72 75 (nga ora 17:00 në mbrëmje deri në 8:00 në mëngjes si dhe në fundjavë: Tel. 052 634 34 34.)

ZYRA E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Në rast të një ardhjeje nga jashtë shtetit ju duhet të lidhni brenda 3 muajsh një sigurim shëndetësor dhe ndaj aksidenteve. Keni ardhur nga një kanton tjetër, duhet t'i paraqitni komunës suaj të re të banimit brenda 30 ditësh një letërnjoftim sigurimi. Arkat e sigurimit shëndetësor janë të detyruara me ligj t'ju pranojnë ju në sigurimin bazë. Persona me veprimtari pune janë si rregull të siguruar ndaj aksidenteve. Kujdesuni për këtë, që ju të mos jeni të siguruar dyfish. Sigurimi bazë mbulon kostot për trajtimin tek mjeket dhe mjekët në degët e përgjithshme të të gjitha spitaleve, të cilat janë në listën e spitaleve të kantonit të Schaffhausen-it. Një pjesë të kostove të trajtimit duhet secili megjithatë gjithmonë ta paguajë vetë (varur nga ekskluziviteti dhe kontributi vetjak). Shteti iu siguron personave të siguruar, çifteve dhe familjeve në gjendje ekonomike modeste miratim të uljes së çmimit të primit. Zyra e sigurimit social të kantonit të Schaffhausen-it përpunon kërkesa për miratimin e uljes së çmimit të primit.

Çdo person mund të lidhë një sigurim të padetyrueshëm si shtesë tek sigurimi bazë, i cili mbulon kosto të tjera si për shembull qëndrimin në spital në repartet private.



- ▶ *Enti Federal për Shëndetësinë (Bundesamt für Gesundheit BAG): Informacione për shëndetin, sigurimet etj.*
- ▶ *Zyra e sigurimit social (Sozialversicherungsamt SVA) Schaffhausen: Formularë kërkesash dhe informacione për një ulje të çmimit të primit dhe informacione për sigurimet sociale.*
- ▶ *Enti Federal për Shëndetësinë (Bundesamt für Gesundheit BAG) – Priminfo: Krahasime të primeve të arkave të sigurimit shëndetësor për sigurimin bazë.*
- ▶ *migesplus.ch – Udhërrëfyesi shëndetësor Zvicër: Broshurë për shëndetin, e botuar nga Enti Federal për Shëndetësinë dhe nga kryqi i kuq zvicëran për të gjitha temat me rëndësi për shëndetin, përkthyer në shumë gjuhë.*

SHËRBIMI I DHËMBËVE

Trajtimet e dhëmbëve, pa marrë parasysh përjashtime të vogla, nuk janë të përmbajtura në katalogun e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm bazë. Kostot më të shumta të mjekut të dhëmbëve paguhen, në përputhje me këtë, nga vetë pacientët. Për fëmijë mund të lidhet një sigurim special për shërbimin e dhëmbëve. Në kantonin e Schaffhausen-it fëmijëve dhe të rinjve iu qëndron e hapur oferta e klinikës shkollore e dhëmbëve. Klinika shkollore e dhëmbëve kryen tek fëmijët e kopshtit të fëmijëve dhe tek nxënësit e nxënës të çdo vit një kontroll. Kontrolli është përkatësisht falas dhe i detyrueshëm. Të gjitha shërbimet e klinikës shkollore të dhëmbëve janë të subvencionuara nëpërmjet kantonit, kështu që ato mund të ofrohen në kushte të leverdishme. Ndihmëse dhe ndihmës profilaktike vizitojnë kopshtet e fëmijëve, shkollat primare dhe shkollat e orientimit dhe i mësojnë fëmijët për higjienën e tyre të gojës dhe për ushqimin e drejtë.

- ▶ *Klinika shkollore e dhëmbëve e kantonit Schaffhausen. Krahas kontrollit dhe trajtimit ka edhe informacione për masat profilaktike të dhëmbëve.*

MBËSHTETJE DHE SHËRBIM NË KANTONIN E SCHAFFHAUSEN-IT

Sëmundje kronike ose invaliditet sjellin me vete krahas ankesave fizike disa vështirësi në jetën e përditshme. Njerëz të moshuar po ashtu janë të konfrontuar me sfidat e reja. Krahas shërbimit dhe mbështetjes në shtëpi ka si alternativë forma të ndryshme banimi si streha hospitalore për përkujdesjen e të moshuarve, ngujime për të moshuarit etj. Në Schaffhausen ka shumë vende këshillimi si për shembull ajo e „Pro Senectute“ ose „Pro Infirmis“ si dhe shërbime mbështetjeje të „Spitex“-it ose të kryqit të kuq, të cilat mund t'ju mbështetin juve gjatë shërbimit dhe përballimit të jetës së përditshme.

- ▶ *Pro Senectute Kanton Schaffhausen: Oferta të ndryshme këshillimi, oferta të kohës së lirë dhe ndihmë në jetën e përditshme për të moshuarit.*
- ▶ *Pro Infirmis Thurgau-Schaffhausen: Këshillime dhe mbështetje për njerëz me një kufizim psikik, fizik ose mendor dhe për të afërmit e tyre, deri në arrijtjen e moshës së „AHV“ (gratë 64 vjet / burrat 65 vjet).*
- ▶ *Krebsliga, Lungenliga, Rheumaliga dhe Diabetes Schaffhausen: Mbështetja të prekurit dhe familjet e tyre në një sërë çështjesh.*
- ▶ *Spitex Kanton Schaffhausen. Shërbimet e „Spitex“-it arrijnë nga shërbimi shëndetësor dhe për të sëmurë mbi lehtësimin në ekonominë shtëpiake dhe kujdestarinë sociale.*
- ▶ *Kryqi i kuq zvicëran Schaffhausen – Kantoni i Schaffhausen-it: Ofron shërbime të ndryshme dhe dhënie ndihme në fushën e shëndetit, në atë sociale dhe të integritetit. Ofertat më të rëndësishme janë shërbimi i udhëtimit, sistemi i thirrjes emergjente dhe shërbimet e lehtësimit të kryqit të kuq.*
- ▶ *palliative.ch: Shoqata zvicëranë që ndërlikohet në mënyrë ndërkantonale, promovon dhe informon mbi çështjet specifike të kujdesit paliativ. Përveç kësaj ekziston një shoqatë kantonale në Schaffhausen.*
- ▶ *Shoqata për çështjet e të rinjve, parandalim dhe ndihmë ndaj varësisë Schaffhausen (Verein für Jugendfragen, Prävention und Suchthilfe Schaffhausen VJPS): Vendi i specializuar për nxitjen e shëndetit, parandalimin, këshillimin ndaj varësisë dhe punë të kërkuar sociale si dhe kuzhina e rrugicës Schaffhausen.*

KOHA E LIRË DHE KULTURA



34

ZBULONI SCHAFFHAUSEN-IN

Regjioni i Schaffhausen-it fton për udhëtime të shumëllojshme zbulimi. Peizazhi i larmishëm i Renit ndërmjet Schaffhausen-it dhe Stein am Rhein ofrojnë përjetime të pakrahasueshme natyrore. Në verë shijon gjysma e Schaffhausen-it të lagurit freskues të Renit në një nga shumë banjat e Renit ose përgjatë peizazhit të arritshëm lirshëm të brigjeve. Në lojën shkëmbyese të stinëve lë përshtypje bukuria plot fuqi e ujëvarës shungulluese së Renit. Shumë joshëse është një vizitë në dimrin me ngricë. Në verë festohet spektakli natyror me një shfaqje me fishekzjarrë. Topografia e gjerë kodrinore dhe pyjet e Randen-it dhe të Reilats-it ftojnë për ecje më këmbë, shëtitje dhe piknikë. Rrjeti i zgjeruar mirë i rrugëve të biçikletave është ideal për turnetë me biçikleta.

- ▶ *KulturLegi Schaffhausen: Me "KulturLegi" njerëzit që marrin shërbime mbështetëse ose kanë të ardhura të ulëta përfitojnë zbritje deri në 70 për qind në shumë oferta në kantonin e Schaffhausen-it dhe shumë të tjera në të gjithë Zvicrën.*
- ▶ *Schaffhauserland Tourismus: Informon mbi vende të shumta ekskursionesh dhe ecje të vogla më këmbë, aktivitete aktuale, gastronomi, sport, kulturë dhe oferta të tjera të kohës së lirë dhe ofron shitje biletash për turne publike, turne në grup, përvoja dhe oferta, teatri i qytetit, udhëtime me anije, evenimente dhe kupona.*
- ▶ *KSS Freizeitpark: Ofron mundësi të ndryshme sportive nga noti, patinazhi dhe voleyboll plazhi deri në shëndet të mirë (Wellness) dhe të qenit në formë sportive (Fitness).*
- ▶ *wanderland.ch: Propozime regjionale dhe lokale për ecje më këmbë me përshkrim rrugë dhe harta për ecjen më këmbë në linjë (online).*
- ▶ *Parku natyror regjional Schaffhausen: Informacione për përjetimin natyror të Schaffhausen-it.*
- ▶ *Naturpark Schaffhausen: Planifiko ekskurzione online në regjionin e Schaffhausen-it.*
- ▶ *rheinfal.ch: Informacione për aktivitetet dhe udhëheqjet përreth dukurisë natyrore të ujëvarës së Renit.*

ÇLODHJA DHE KOHA E LIRË

Takimet në jetën e përditshme dhe zënia me punë në kohën e lirë janë të rëndësishme për mirëqenien. Ato i shërbejnë lirshmërisë, të mësuarit, shëndetit dhe e zgjerojnë rrethin shoqëror. Ato ndihmojnë të lëshosh rrënjë në vendin e banimit.

Jeta e lagjes dhe e fshatit

Fshatra dhe lagje organizojnë festa ose aktivitete, të cilat ju mund t'i vizitoni dhe ku mund të merrni pjesë aktive në zhvillim. Më e mira është të informoheni tek të njohurit tuaj, tek farefisi, shokët dhe tek fqinjët. Më tej ka në lagjet dhe në fshatrat vende takimesh, si për shembull vende lojërash, pishina ose qendra të lagjes ku mund të lidhen kontakte. Nëse ju interesoheni në veçanti për zhvillimin në mjedisin tuaj direkt dhe dëshironi të kontribuoni me diçka aktivisht për bashkëjetesën në lagje ose në fshat, ju mund të angazhoheni në një shoqatë lagjeje ose fshati.

Komunat e kantonit Schaffhausen mbështetin, në pjesën më të madhe nën emrin e tyre të komunës, një faqe interneti, e cila informon për zhvillimin aktual të ngjarjeve, politikën dhe administratën. Në qytetin e Schaffhausen-it ajo ndihmon përveç kësaj zhvillimin e lagjes në rast të çështjeve dhe projekteve, të cilat nxitin bashkëjetesën, shkëmbimin dhe lidhjen e rrjetit social në lagjet e qytetit të Schaffhausen-it dhe përmirësojnë kualitetin e jetës. Ajo kryen në lagje të ndryshme takime lagjesh, në të cilat takohen njerëzit e çdo moshe dhe prejardhjeje.

- ▶ *Qyteti i Schaffhausen-it – Quartiervereine: Ofertë e shumanshme në aktivitete dhe informacione nga lagjet e Schaffhausen-it.*
- ▶ *Benevol Schaffhausen: Vend i specializuar për punë vullnetare ndërmjetson dhe kërkon vullnetarë për shërbime në të gjitha fushat e jetës.*
- ▶ *Quartierentwicklung Schaffhausen: Pikat e takimit dhe projektet e lagjeve të ndryshme në Schaffhausen.*



Shoqata dhe klube

Në kanton dhe në komuna ka shoqata të ndryshme për gra, burra, fëmijë, të rinj dhe njerëz të moshuar. Për shembull lidhje të të rinjve si udhërrëfyes, shoqata diturie natyre ose historike, klube të qarkullimit, klube shahu, shoqata grash, shoqata muzike dhe kulture, parti politike dhe shoqata sporti të të gjitha llojeve. Përveç kësaj ka edhe në shumë komuna oferta si gjimnastikë prindër-fëmijë (gjimnastikë-EIKI), gjimnastikë shëndeti, gjimnastikë për të moshuar, kore dhe grupe teatri. Oferta dhe shoqata iu qëndrojnë hapur të gjithë personave të interesuar. Ato gëzohen për anëtarë të rinj. Informoheni tek komuna e banimit për ofertat e ndryshme.

Në faqen e internetit të komunës suaj ju gjeni informacione për shoqatat në vend.

- ▶ *wegweiser.sh – die Schaffhauser Informationsplattform für Kinder, Jugendliche und Familie: Auf der Online-Plattform findet man Beratungsstellen, Freizeit- und Betreuungsangebote, Kurse, Elternbildungskurse und mehr.*
- ▶ *Integres – Integrationsfachstelle für die Region Schaffhausen: Im Kanton gibt es zahlreiche Ausländer- oder Kulturvereine. Eine entsprechende Übersicht finden Sie auf der Internetseite der Integrationsfachstelle.*

Kultura

Regjioni i Schaffhausen-it disponon një ofertë të larmishme dhe të shumëllojshme kulturore. Duke filluar me teatrin e qytetit dhe tribunat e vogla në komunat e ndryshme, vazhduar me festivalet regionale të teatrove, ju mund të merrni pjesë këtu në një jetë të gjallë teatri. Programi i larmishëm i filmit të kinemave në Schaffhausen dhe Stein am Rhein plotësohet nëpërmjet festivalesh të vogla të këndshme filmash dhe kinemasë spektakulare në ambient të hapur në „Munotzinne“. Muzeu i gjithë shenjtoreve i njohur gjerë përtej regjionit dhe galeritë e ndryshme ftojnë në ekspozita tërheqëse. Muzetë lokale si muzeu i prodhimit të verës i Schaffhausenn-it në Hallau tregojnë veçantitë, zakonet dhe traditat regionale.

Me festivalin e xhazit në Schaffhausen, festivalin muzikor “Stars in Town”, festivalin ndërkombëtar të “Bach” dhe serinë e koncerteve „Schaffhausen Classic“, si dhe vende të shumta koncertesh si qendra kulturore Kammgarn dhe klubi muzikor TapTap, pëlqesit e muzikës së çdo zhanri shpërblehen denjësisht.

- ▶ *kulturraum.sh: Platforma kulturore e qytetit dhe kantonit të Schaffhausen-it informon mbi ngjarjet aktuale, hapësirat dhe mundësitë e promovimit për të krijuarit kulturor.*
- ▶ *nordagenda.ch: Kalendar i aktiviteteve në linjë (online) për regjionin e Schaffhausen-it*
- ▶ *Blauburgunderland Schaffhausen: Aktivitetet përreth verës dhe regjionit të verës së krahinës Blauburgunder-it. Kalendarë të aktiviteteve javore botohen si shtojca të gazetave regjionale.*

Biblioteka dhe ludoteka

Bibliotekat ofrojnë hyrje të lirë në informacionet dhe dijet për të gjithë. Bibliotekat “Agnesenschütte” dhe Biblioteka e qytetit në sheshin „Münsterplatz” janë biblioteka publike të qytetit të Schaffhausen-it. Ato drejtohen pa përkufizim ndaj të gjithëve, nxitin formimin e lirë të opinionit dhe bazarinë e shanseve dhe ofrojnë hapësira për vetëstudim, takime dhe shkëmbime mendimesh. Anëtarësia është falas dhe i qëndron hapur gjithë popullsisë të regjionit.

Biblioteka “Agnesenschütte” ofron literaturë aktuale, edhe shumëgjuhëshe objektive dhe zbatimëse për të gjitha moshat. Biblioteka e qytetit në sheshin „Münsterplatz” është arkivi për literaturë më të vjetër.

Në komunat Hallau, Oberhallau, Neunkirch, Wilchingen, Schleithelm, Neuhausen am Rheinflall, Stein am Rhein dhe Thayngen ju gjeni gjithashtu biblioteka publike. Në qendrën familjare në Schaffhausen dhe në Stein am Rhein ndodhen lodratekat e kantonit. Lodratekat japin hua lojëra dhe sende lojërash.

BLERJET/PUNËT E PËRDITSHME



36

BLERJA

Regjioni Schaffhausen disponon mundësi të shumëllojshme blerjeje. Dyqane për mjete ushqimore, dyqane speciale, dyqane mallrash dhe qendra blerjeje ofrojnë të gjitha, çfarë të dëshiron zemra: nga prodhimet për nevojat e përditshme, duke kaluar në moda deri tek orët, orenditë dhe stolitë. Qendrat e vjetra të ruajtura mirë të qyteteve Stein am Rhein dhe Schaffhausen janë pa makina dhe ftojnë për endje dhe dalje të rehatshme në pazar. Shumë komuna mbajnë një faqen e tyre të internetit një listë me dyqane. Informacione për psonisjen në qytetin e vjetër ju merrni në „Pro City“.

Oraret e hapjes

Oraret e hapjes së dyqaneve janë ndryshe të rregulluara. Shumë dyqane hapen në mëngjes midis orës 8:00 dhe 9:00 dhe mbyllen midis orës 18:30 dhe 19:00. Disa nga dyqanet më të mëdha janë të hapura më gjatë.

Çmimet

Çmimet e shënuara të mallrave janë detyruese dhe përfshijnë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Kryesisht paguhet me të holla në dorë, me kartë-EC, kartë poste ose aplikacionin e pagesës TWINT. Shumë dyqane pranojnë kartat e zakonshme të kredive.

Direkt nga ferma

Në tregun javor me ngjyra, në dyqanin e oborrit ose në tregun e fermerëve ju gjeni produkte të freskëta nga regjioni.

Tregjet e javës të Schaffhausen-it:

Të martë ora 7:00 – 11:00 & të shtunë ora 7:00 – 12:00

- ▶ *Schaffhuser Puuremärkt (Tregu i fermerëve të Schaffhausen-it): Të martë ora 8:00 – 12:00, të premte ora 9.+:00 – 17:30 dhe të shtunë ora 8:00 - 12:00*
- ▶ *„Neuhuusermärkt“ (Tregu i Neuhausen-it): Të premte ora 15:00 - 18:30*
- ▶ *Pro City Schaffhausen: Informacione për psonisjen në qytetin e vjetër të Schaffhausen-it.*
- ▶ *Shoqata e fermerëve të Schaffhausen-it: Informacione dhe adresa për tregtimin direkt të fermerëve të Schaffhausen-it. Udhëzime për dyqanet e oborreve dhe vendet e tregut.*

ZYRA, POSTA DHE BANKA

Vendet zyrtare më të shumta kantonale ndodhen në qytetin e Schaffhausen-it. Vendet e ndryshme kantonale dhe komunale paraqitin orare të ndryshme hapjeje. Informohuni në administratat tuaja komunale ose në faqen e internetit të kantonit Schaffhausen.

Posta ju ofron juve shërbime në zyrat e postës, në agjenturat e postës ose në komunat e vogla, në shërbime ndërtesash. Oraret e hapjes janë sipas vendndodhjes, të ndryshme. Më gjatë është hapur zyra kryesore e postës përballë stacionit të trenit në Schaffhausen: Të hënë - të premte ora 7:30 – 18:30, të shtunë ora 8:00 - 16:00.

Në kantonin e Schaffhausen-it ushtrojnë banka vepruese regjionale ose internacionale një ose më tepër filiale. Oraret e hapjes janë të ndryshme. Filiali i bankës që ka të bëjë me këtë ju jep me kënaqësi informacion.

- ▶ *Posta zvicerane: Informacione lidhur me shërbimet dhe kostot e postës.*



SISTEMI DEMOKRATIK

Demokracia zvicerane ofron shumë mundësi të shprehjet dhe të merret pjesë në jetën publike. Me marrjen e nënshtetësisë ju merrni të gjitha të drejtat politike si në nivelin nacional, ashtu edhe për kantonin e Schaffhausen-it dhe për komunën tuaj të banimit. Të drejtat politike, të quajtura edhe të drejta të popullit, janë me shumë ndikim të gjerë: e drejta e votës, e drejta e zgjedhjes, e drejta e iniciativës, e drejta e referendumit. Populli mund të propozojë kështu, të ndryshohet kushtetuta (e drejta e iniciativës) ose mund ta kundërshtojë një ligj të hartuar nga parlamenti (e drejta e referendumit). Nëse në Zvicër bëhet fjalë për «sovrani», është e kuptuar me këtë populli zviceran. Të drejtat politike ushtrohen në tre nivelet e shtetit: Federata, kantonet, komunat.

Zgjedhjet dhe votimet

Parlamentet konfederativë, kantonale dhe komunale dhe ekzekutivët zgjidhen çdo katër vjet nga populli. Krahas zgjedhjeve thirren votueset dhe votuesit po ashtu për projekte objektive në kutitë e votimit. Përveç kësaj që prej dekadash kantonin e Schaffhausen-it tregon në Zvicër pjesëmarrjen më të lartë në votime. Kjo është edhe për shkak të kësaj, që në kantonin e Schaffhausen-it ekziston detyrimi për të votuar. Kush nuk merr pjesë në votim, paguan sipas ligjit të zgjedhjeve një «gjobë» prej gjashtë franga.

Ndarja e pushtetit

Shteti është i ndarë në tre fusha. Parlamenti (legjislativ), qeveria (ekzekutiv) dhe gjykata (juridikativ). Legjislativi lëshon ligje dhe kontrollon qeverinë dhe administratën. Ekzekutivi i zbaton ligjet, qeveris dhe administron shtetin. Juridikativi vendos, gjykon, dënon dhe mbron. Për çdo fushë ka në nivelet federatë, kanton dhe komunë institucione të ndara nga njëri-tjetri.

Në nivelin e federatës e formon këshilli i federatës qeverinë zvicerane. Ajo zgjidhet nga parlamenti. Parlamenti zgjidhet nga ana tjetër nga populli dhe përbëhet nga dy këshille, këshillin nacional dhe nga përfaqësia e kantoneve. Kantonin e Schaffhausen-it është i përfaqësuar nga përkatësisht dy persona në këshillin nacional dhe në përfaqësinë e kantoneve.

Gjykata federale zgjidhet nga parlamenti. Kantonin e Schaffhausen-it dhe komunat e tij e kanë organizuar si vijon ndarjen e pushtetit:

Legjislativi

Kantoni: Autoriteti ligjvënës i kantonit është këshilli i kantonit. 60 anëtarët përfaqësojnë qarqet e ndryshme dhe partitë politike.

Komunat: Legjislativi i qytetit të Schaffhausen-it është këshilli i madh i qytetit. Në disa komuna si Neuhausen am Rheinfal, Stein am Rhein, Beringen dhe Thayngen e ushtron këtë funksion këshilli i banorëve. Në komunat e tjera është asambleja e komunave.

Ekzekutivi

Kantoni: Qeveria e kantonit përbëhet nga pesë këshilltare të qeverisë respektivisht këshilltarë të qeverisë, të cilët udhëheqin përkatësisht një departament. Presidiumi i qeverisë merret përsipër në cikël vjetor nga një këshilltar i qeverisë ose një këshilltarë e qeverisë.

Komunat: Ekzekutivi i qytetit të Schaffhausen-it është këshilli i qytetit. Stein am Rhein disponon po ashtu një këshill qyteti, në komunat e tjera autoriteti ekzekutues vendoset nga këshilli i komunës.



38

Juridikativi

Gjykata e Lartë është gjyqi më i lartë në kantonin e Schaffhausen-it. Ajo është përgjegjëse për marrjen e vendimeve në të gjitha fushat ligjore dhe mbikëqyrëse mbi të gjitha autoritetet e pavarura të drejtësisë të kantonit. Këto janë për shembull gjykata e kantonit, zyra e zbatimit të detyrueshëm dhe konkursit, zyra e gjykatësit të pajtimit, zyra e pajtimit për punët e qirave, autoriteti për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të rriturve e më tepër.

- ▶ *Kantoni i Schaffhausen-it – Autoritetet: Informacione të detajuara për ekzekutivin, legjislativin dhe juridikativin e kantonit.*
- ▶ *ch.ch: Informacione të hollësishme dhe aktualitetet për Zvicrën.*

MUNDËSI PJESËMARRJEJE POLITIKE PËR TË HUAJAT DHE TË HUAJT

Megjithëse në kantonin e Schaffhausen-it të huajat dhe të huajt nuk mund t'i shfrytëzojnë të drejtat e përmendura politike, ka mundësi të shumta të mëtejshme, të merret pjesë në jetën publike dhe të influencohet mbi të ardhmen e bashkësisë. Një e huaj ose një i huaj mund të merret në çdo kohë me punë në një shoqatë të lagjes, në një bashkim lokal, në një organizatë profesionale, në një klub sportiv ose në një komision këshillimi. Një person i huaj zotëron në Zvicër si një zvicerane dhe një zviceran të drejtën e peticionit. E drejta e peticionit i jep secilit mundësinë, të drejtojë pyetje, propozime, kritikë ose ankesë në autoritetet në nivel të komunës, kantonit ose federatës. Me këtë ka mundësi që të ndikohet mbi vendime të marra nga organet shtetërore.

MARRJA E NËNSHTETËSISË

Me marrjen e nënshtetësisë njeriu përfiton të drejtat politike në Zvicër. Të drejtën e nënshtetësisë zvicerane mund ta kërkojnë persona, të cilët banojnë për një kohë të gjatë në Zvicër. Nëse zbatohet e drejta e rregullt, një procedurë e thjeshtuar ose një marrje e lehtësuar e nënshtetësisë, kjo varet kryesisht nga kohëzgjatja e qëndrimit dhe shkakut i qëndrimit në Zvicër. Në rast të marrjes të lehtësuar të nënshtetësisë (më së shumti bashkëshortë të shtetasve dhe shtetasve zvicerane/ë) kërkesa dorëzohet direkt tek federata, ndryshe secili e dorëzon kërkesën në kantonin e Schaffhausen-it tek komuna e tij e banimit.

Pritet që personi me dëshirën e marrjes së nënshtetësisë të plotësojë kushtet paraprake të mëposhtme:

- Ai është përfshirë në raportet komunale, kantonale dhe zvicerane;
- Ai i njej doket e jetesës zvicerane, zakonet dhe traditat;
- Ai merr parasysh rendin ligjor dhe nuk rrezikon sigurinë e brendshme dhe të jashtme të Zvicrës;
- Ai disponon njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes
- Ai vërteton marrëdhënie të rregullta personale dhe financiare.

(Shpjegime në ligjin e të drejtës së nënshtetësisë së kantonit Schaffhausen, neni 6).

- ▶ *Kantoni Schaffhausen – Zyra e drejtësisë dhe komunave (Amt für Justiz und Gemeinden): Informacione mbi marrjen e nënshtetësisë si dhe formularë kërkesash për përfitimin e të drejtave të shtetasit.*



„INTEGRES“, VENDI I SPECIALIZUAR PËR INTEGRIMIN PËR REGJIONIN E SCHAFFHAUSEN SI DHE PIKË KONTAKTI PËR MBROJTJEN NDAJ DISKRIMINIMIT DHE KONFLIKTEVE NDËRKULTURORE

Ju jetoni dhe punoni në regjionin tonë dhe dëshironi të orientoheni më mirë këtu. Ne do të jemi për ju me dëshirë një ndihmë gjatë integrimit tuaj në vendin tonë dhe në regjionin tonë. Ekipi ynë ju ndihmon juve në rast çështjesh për jetën e përditshme ose gjatë zgjedhjes së kurseve të përshtatshme. Në kantonin e Schaffhausen-it ka një gamë të gjerë kursesh të gjermanishtes dhe të integrimit.

Fushat e konsultimit

- Këshilla për kurset e gjermanishtes dhe të integrimit
- Ndihmoni gjatë plotësimit të formularëve dhe gjatë korrespondencës me autoritetet, sigurimet ose institucionet
- Këshilla për çështjet e përditshme dhe referim në vende të përshtatshme të specializuara
- Këshilla në rast të racizmit, diskriminimit dhe konflikteve ndërkulturore
- Informacioni fillestar për të sapoardhurit

Shpenzimet

Këshillimi është falas.

Oraret e hapjes

Pa paralajmërim në oraret vijuese të hapjes:

të hënë dhe të mërkurë: ora 9:00 – 11:00 /

14:00 – 17:00

të martë: mbyllur

të enjte dhe të premte: ora 14:00 - 17:00

Jashtë orareve të hapjes: Termin sipas marrëveshjes.

Ort

Integres

Integrationsfachstelle für die Region Schaffhausen

Krebsbachstrasse 61

8200 Schaffhausen

Kontakt

Telefon: 052 624 88 67

E-Mail: info@integres.ch

HISTORIA

“Integres” u themelua në verën e vitit 2004 si një qendër kompetencash për çështjet e integrimit. Vendi i specializuar për integrimin, megjithatë, mund të shikojë prapa në një përvojë dukshëm më të gjatë. Që në vitin 1972, një lidhje e gjerë krijimi nga shoqëria civile, ekonomia dhe politika themeloi pikën e kontaktit të Schaffhausen-it për të huajt zviceranë me synimin për të mbështetur integrimin e popullsisë së huaj dhe për të promovuar shkëmbimin kulturor. Në vitet që pasuan, pika e kontaktit formoi një nga hallkat lidhëse më të rëndësishme midis popullsisë migrante dhe atdheut të tyre të ri. Ndihma ishte shpesh e orientuar drejt jetës së përditshme; kështu, ata që kërkonin këshilla u mbështetën gjatë plotësimit të saktë të formularëve zyrtarë ose gjatë caktimit të një takimi me mjekun. Sot “Integres” vazhdon të japë këshilla, por në rend të parë shërben si pikë rrotullimi dhe, si departament i specializuar, është i përkushtuar për integrim të suksesshëm si në aspektin strukturor ashtu edhe në atë konceptual.

